



Gjeneralmajor Manushaqe Shehu përshëndet stërvitjen 'Defender 23'

'Defender 23' për herë të dytë në Shqipëri, vjen si një bashkëpunim i frytshëm i Forcave të Armatosura Shqiptare me ato të partnerëve tanë të NATO-s. 'Defender Europe 23' është një stërvitje e përbashkët vjetore, shumëkombëshe, e udhëhequr nga ushtria amerikane në shkallë të gjerë, e krijuar për të ndërtuar gatishmërinë dhe ndërveprueshmërinë midis SHBA-së, NATO-s dhe ushtrive partnere. Të mbledhur në Zall-Herr, për

të përshëndetur fillimin e kësaj stërvitjeje të rëndësishme për partneritetet tona me prezencë të anëtarëve të Task Forcës së Jugut nga Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kosova dhe Shqipëria, në emër të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, përshëndeti gjeneralmajor Manushaqe Shehu, e cila në fjalën e saj drejtuar të pranishmëve do theksonte:

"Qëllimi i pjesëmarrjes në 'Defender Europe 23' është të demonstrojë aftësitë e forcave tona të armatosura për të koordinuar dhe operuar në një mjedis shumëkombësh për të kryer operacione me spektër të plotë. Kjo stërvitje nuk është diçka e re për ne, por do të jetë një mundësi jo vetëm për ta prituar atë, por edhe për të tejkaluar atë që u arrit gjatë 'Defender Europe 21', që ishte vërtet një histori suksesi..."

» faqe 2



"Defender Europe 2023", garancia e paqes, stabilitetit dhe sigurisë



» faqe 3

Ministri Peleshi: Rikonfirmoj mbështetjen politike dhe logjistike ndaj popullit ukrainas

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji morën pjesë virtualisht në takimin e 12-të të Grupit të Kontaktit për Ukrainën. Mes të tjerash, nga ana e tij ministri Peleshi rikonfirmoi mbështetjen politike të Shqipërisë, krah aleatëve perëndimorë, vijimin e ndihmave logjistike si kontribut i nevojshëm për popullin ukrainas në mbrojtje të integritetit territorial dhe paqes...



» faqe 2

Baza Ajrore Farkë zhvillon stërvitjen "Astral Knight"

Në kuadër të stërvitjes "Defender 23", Forca Ajrore mirëpret efektivin dhe helikopterët e USAF si pjesëmarrës në stërvitjen "Astral Knight". Qëllimi i kësaj stërvitjeje do të jetë rritja e aftësive operacionale të Forcave Ajrore Shqiptare për të bashkëpunuar me forcat ajrore të vendeve aleate dhe jo vetëm për kryerjen e operacioneve ajrore komplekse si: monitorim/kontroll të hapësirës ajrore, planëzim dhe zhvillim të mbrojtjes ajrore në mënyrë aktive si dhe kryerja e operacioneve të evakuimit të personelit ushtarak, i cili ndodhet...



» faqe 4

AFA, certifikata mirënjohjeje nga SHSHPFA, Arben Kingji

Në auditoriumin e Ministrisë së Mbrojtjes, me rastin e 65-vjetorit të krijimit të AFA-së, u mbajt ceremonia e certifikimit të personelit të Akademisë së Forcave të Armatosura. Me motivacionin "Për kontribut të veçantë në shërbim të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për kryerjen me korrektësi dhe përgjegjësi të lartë të detyrave të ngarkuara", një vlerësim ky i bërë nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji. Në ceremoni i pranishëm ishte dhe komandanti i AFA-së, gjeneral...



» faqe 5

Ministri Peleshi: Rikonfirmoj mbështetjen politike dhe logjistike ndaj popullit ukrainas

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji morën pjesë virtualisht në takimin e 12-të të Grupit të Kontaktit për Ukrainën. Mes të tjerash, nga ana e tij ministri Peleshi rikonfirmoi mbështetjen politike të Shqipërisë, krah aleatëve perëndimorë, vijimin e ndihmave logjistike si kontribut i nevojshëm për popullin ukrainas në mbrojtje të integritetit territorial dhe paqes.



Gjeneralmajor Manushaqe Shehu përshëndet stërvitjen 'Defender 23'

'Defender 23' për herë të dytë në Shqipëri, vjen si një bashkëpunim i frytshëm i Forcave të Armatosura Shqiptare me ato të partnerëve tanë të NATO-s.

'Defender Europe 23' është një stërvitje e përbashkët vjetore, shumëkombëshe, e udhëhequr nga ushtria amerikane në shkallë të gjerë, e krijuar për të ndërtuar gatishmërinë dhe ndërveprueshmërinë midis SHBA-së, NATO-s dhe ushtrive partnere.

Të mbledhur në Zall-Herr, për të përshëndetur fillimin e kësaj stërvitjeje të rëndësishme për partneritetet tona me prezencë të anëtarëve të Task Forcës së Jugut nga Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kosova dhe Shqipëria, në emër të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, përshëndeti gjeneralmajor Manushaqe Shehu, e cila në fjalën e saj drejtuar të pranishmëve do theksonte: "Qëllimi i pjesëmarrjes në 'Defender Europe 23' është të demonstrojë aftësitë e forcave tona të armatosura për të koordinuar dhe operuar në një mjedis shumëkombësh për të kryer operacione me spektër të plotë. Kjo stërvitje nuk është diçka e re për ne, por do të jetë një mundësi jo vetëm për ta pritur atë, por edhe për të tejkaluar atë që u arrit gjatë 'Defender Europe 21', që ishte vërtet një histori suksesi jo vetëm për Forcat e Armatosura shqiptare, por për të gjithë Kombin Shqiptar. Edhe pse është stërvitje e përvitshme, 'Defender Europe 23' e gjen Aleancën në një mjedis sigurie të përkeqësuar si rezultat i agresionit rus në Ukrainë dhe është stërvitja e parë sipas Konceptit të ri Strategjik të NATO-s, ku parandalimi dhe mbrojtja, parandalimi dhe menaxhimi i krizës janë dy nga tre detyrat kryesore të Aleancës, dhe të cilat shumë mirë mund të testohen si pjesë e skenarit



të trajnimit. Realizimi i stërvitjeve të tilla në situatën e sotme geopolitike, thekson unitetin dhe vendosmërinë e aleancës dhe partnerëve të saj për të ruajtur paqen dhe sigurinë në rajon dhe jo vetëm.

Më tej gjeneralmajor Shehu tha: "NATO është një aleancë mbrojtëse, nuk kërkon konfrontim dhe nuk përbën kërcënim për asnjë vend apo aleancë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se NATO nuk është e gatshme, e aftë dhe e përkushtuar për të mbrojtur veten nga çdo agresor potencial.

Qëllimi i tij kryesor dhe përgjegjësia më e madhe për të siguruar mbrojtjen tonë kolektive, dhe ky është qëllimi i kësaj stërvitjeje, të reagojë ndaj një skenari të Nenit 5.

Stërvitjet kryesore të përbashkëta në

përgjithësi, dhe seritë 'Defender' në veçanti, kontribuojnë dhe përmirësojnë më tej sigurinë e krahut lindor të NATO-s, nëpërmjet trajnimit në përputhje me standardet dhe procedurat e NATO-s. Ato gjithashtu lejojnë përshtatjen e këtyre rregullave dhe standardeve për të përballuar sfidat e reja dhe të reja në fushën e betejës bashkëkohore, në mënyrë që të pengojnë një agresor të mundshëm.

Nisur nga rëndësia e kësaj stërvitjeje, autoritetet në Ministrinë e Mbrojtjes së Shqipërisë dhe Shtabin e Përgjithshëm kanë ndjekur nga afër ecurinë e arritur deri tani gjatë procesit të planifikimit.

Është kënaqësi që në emër të tyre ju uroj të gjithëve një realizim të suksesshëm të ushtrimit dhe ju lutem të përpiqeni të përfitonit më të mirën prej tij."



"NATO ËSHTË NJË ALEANCË MBROJTËSE, NUK KËRKON KONFRONTIM DHE NUK PËRBËN KËRCËNIM PËR ASNJË VEND APO ALEANCË. MEGJITHATË, KJO NUK DO TË THOTË SE NATO NUK ËSHTË E GATSHME, E AFTË DHE E PËRKUSHTUAR PËR TË MBROJTUR VETEN NGA ÇDO AGRESOR POTENCIAL. QËLLIMI I TIJ KRYESOR DHE PËRGJEGJËSIA MË E MADHE PËR TË SIGURUAR MBROJTJEN TONË KOLEKTIVE, DHE KY ËSHTË QËLLIMI I KËSAJ STËRVITJEJE, TË REAGOJË NDAJ NJË SKENARI TË NENIT 5.



“Defender Europe 2023”, garancia e paqes, stabilitetit dhe sigurisë

“Defender Europe 2023”, stërvitja e përbashkët shumëkombëshe, drejtuar nga Komanda Europiane e SHBA-ve, nisi në Shqipëri me ceremoninë e hapjes, e cila u zhvillua në sheshin “Nënë Tereza” në prani edhe të qytetarëve. Të pranishëm ishin liderët më të lartë politik dhe ushtarakë të vendit tonë si dhe përfaqësues të vendeve aleate mes të cilëve dhe ambasadorja e SHBA-ve, znj. Yuri Kim.

Fjalën e hapjes e mbajti shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji, i cili tha se: “Kjo stërvitje demonstroi angazhimin e SHBA-ve dhe NATO-s në garantimin e paqes, stabilitetit dhe sigurisë. Kjo stërvitje na mundëson forcimin e kapaciteteve tona. Ajo është një mesazh për kundërshtarët tanë të mundshëm, që ne jemi të përgatitur dhe të bashkuar për të përballuar sfidat e përbashkëta.”

Më tej, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi e cilësoi “Defender Europe 23”, një stërvitje e përmasave të jashtëzakonshme, ku Forcat e Armatosura të Shqipërisë ndihen krenarë që marrim pjesë, pas suksesit të plotë të arritur dy vjet më parë në “Defender Europe 21”.

“‘Defender Europe 23’ rikonfirmon bashkëpunimin e ngushtë që Shqipëria ka me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në vazhdimësi dhe një partneriteti të fortë strategjik në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, për të cilin ne jemi thellësisht mirënjohës. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë pjesë e rëndësishme e kësaj stërvitjeje dhe, jo pa krenari, pohoj se po përfaqësohen denjësisht, duke treguar një profesionalizëm të lartë. Nëse dy vjet më parë u testuam me sukses të plotë për kapacitetet tona në rolin e NATO-s si ‘Host Nation Support’, sot me po aq sukses po përballojmë të tjera detyra, përfshirë këtu edhe ato drejtuese dhe koordinuese të ‘Task Force South’”, - theksoi gjatë fjalës së tij ministri Peleshi.

“Synimi ynë është të tregojmë se jemi në gjendje të përballojmë çdo situatë që mund të krijohet në fushën



e Sigurisë dhe të Mbrojtjes, duke përmbushur çdo detyrë dhe angazhim që na takon si vend i NATO-s. Por, sigurisht që, një tjetër synim madhor është, të sigurojmë qytetarët tanë se Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë gati në çdo kohë të përmbushin detyrën e tyre bazë: atë të mbrojtjes së kufijve të atdheut!”, - theksoi ministri i Mbrojtjes.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë Sh. T. Z. Bajram Begaj, njëherësh edhe Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, u shpreh se: “Shqipëria është e përkushtuar në misionin e saj si faktor stabilizues në Ballkan dhe eksportuese e sigurisë në rajon e më gjerë. Çdo investim më shumë drejt forcimit të kapaciteteve mbrojtëse, është një investim më shumë drejt stabilitetit, është një investim për të garantuar një të ardhme më të paqte të brezave të rinj, të cilët kurrësi nuk duhet të përballen me pasojat shkatërruese që sjellin konfliktet. Koha për të marrë përgjegjësitë tona është tani dhe reagimi duhet t’i përgjigjet sfidave aktuale”, - u shpreh presidenti.

Nga ana e tij kryeministri Edi Rama theksoi se Shqipëria sot është më lart se kurrë në aspektin e respektit ndërkombëtar, duke e cilësuar privilegj që vendi pret për të dytën herë stërvitjen

“Defender Europe 2023”: “Shqipëria nuk ka qenë kurrë më lart në nivelin e respektit ndërkombëtar. Sot e ulur në tryezën e Këshillit të Sigurisë krah për krah Shteteve të Bashkuara si bashkëpunëbajtëse për çështjen e Ukrainës, ajo merr një profil dhe një rol, që jo vetëm e ngarkon me përgjegjësi të jashtëzakonshme, por

edhe vë në dukje se çfarë përparimi dhe pjekurie ka arritur vendi ynë”, - tha kryeministri Rama.

“Kjo stërvitje na rikujton se pavarësisht gjuhës që flasim, pavarësisht flamurit, jemi të lidhur pazgjidhshmërisht me ato vlera dhe parime, të cilat janë të kërcënuara po njësoj për secilin prej nesh. Të gjithë

së bashku jemi të imponuar nga historia dhe ardhmëria jonë që të funksionojmë në unitet të plotë.

Vitin e shkuar erdhi lajmi i mirë për ngritjen e Shtabit të Bazës së Forcave Operacionale Speciale, çka dëshmon se Shqipëria mbetet jo vetëm një aleat i fortë dhe i besueshëm i SHBA-ve dhe NATO-s, por Shqipëria bëhet hap pas hapi një pikë e palëvizshme referimi në kontinentin tonë”, - theksoi kryeministri Rama.

Në mesazhin e saj, ambasadorja amerikane Yuri Kim tha se kjo stërvitje tregon se SHBA-të së bashku me vendet aleate mund të kryejnë çdo mision: “Jemi këtu si aleatë, miq dhe partnerë, amerikanë dhe shqiptarë që qëndrojnë krah për krah, dikur të ndarë veçmas, tani aleatë të NATO-s dhe partnerët më të afërt ushtarakë. Në dy vite, që prej ‘Defender 2021’, bota ka ndryshuar, Shqipëria dhe aleatët tanë të NATO-s janë më të bashkuar dhe më të fortë se kurrë”, - theksoi ambasadorja Kim.

Në fund të pranishmit vizituan stendat ku ishin vendosur armatime të ushtrisë shqiptare.





Gjeneralmajor Shehu mori pjesë në ceremoninë e certifikimit të KTHOSH

Zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu mori pjesë në ceremoninë e certifikimit të kursantëve të Kursit Themelor të Shtabit (KTHOSH), raundi II.

Në ceremoni morën pjesë edhe komandantë forcash dhe të njëjseve autonome të FA-së, drejtorë drejtorish të Shtabit të Përgjithshëm, atasheu i Republikës së Kosovës i akredituar në Shqipëri, kolonel Enver Hoti, stafi akademik dhe mbështetës si dhe pedagogë dhe kursantë. Gjeneralmajor Manushaqe Shehu

në përshëndetjen e saj drejtuar të pranishmëve në ceremoni, pasi falënderoi kursantët për përfundimin me sukses të kursit, vuri theksin në mjedisin e sigurisë në të cilin jetojmë sot, i cili kërkon ndryshim të shpejtë të vendimmarrjeve, dhe rëndësinë e plotësimit të kurrikulës mësimore me informacionet më të fundit që koha kërkon.

Ceremonia u përmbyll me dhënien e certifikatave kursantëve të Kursit të Themelor të Oficerit të Shtabit dhe me një foto të përbashkët.



Baza Ajrore Farkë zhvillon stërvitjen “Astral Knight”

Në kuadër të stërvitjes “Defender 23”, Forca Ajrore mirëpret efektivin dhe helikopterët e USAF si pjesëmarrës në stërvitjen “Astral Knight”.

Qëllimi i kësaj stërvitjeje do të jetë rritja e aftësive operacionale të Forcave Ajrore Shqiptare për të bashkëvepruar me forcat ajrore të vendeve aleate dhe jo vetëm për kryerjen e operacioneve ajrore komplekse si: monitorim/kontroll të hapësirës ajrore, planëzim dhe zhvillim të mbrojtjes ajrore në mënyrë aktive si dhe kryerja e operacioneve të evakuimit të personelit ushtarak, i cili ndodhet në zona ku zhvillohen luftimet (Combat Search and Rescue), veçanërisht ekuipazheve fluturuese të dëmtuara/rëzuara në zonën e luftimit.

Deri më tani, ekuipazhet fluturuese të të dyja vendeve (USAF të dislokuar në Bazën Ajrore Farkë dhe Skuadronin Operacional të Helikopterëve “AS532AL Cougar” të BAF), kanë zhvilluar fluturime kompaktësuese me fokus, rikonicionin e zonave ku do të zhvillohet stërvitja si dhe kompaktësimin e veprimeve luftarake dhe jo luftarake që do të zhvillohen gjatë fazës së dytë të stërvitjes.

Zhvillimi i kësaj stërvitjeje ka një rëndësi të veçantë për Forcat Ajrore shqiptare pasi është një stërvitje, e cila do të zhvillohet ditën dhe natën, si në tokë ashtu edhe në det, e cila tregon edhe një herë objektivin tonë për përmbushjen sa më mirë të angazhimeve që Forcat e Armatosura Shqiptare kanë në kuadër të mbrojtjes kolektive.



Gjatë muajit maj 2023, në bashkitë e Tropojës dhe Librazhdit, forcat xheniere kanë ndërtuar tre ura tip “Bailey”. Ndërtimi i tyre mundëson lidhjen e më shumë se 2 300 banorëve të këtyre zonave midis tyre.

Me rreth 13 forca dhe 5 mjete ato kanë bërë të mundur ndërtimin e dy urave në bashkinë e Tropojës në fshatin Kuçanë dhe në grykën e Sylbicës mbi lumin e Tropojës.

Dy urat, secila me një gjatësi 15 metra dhe me seksion 2/1 të ndërtuara në fshatin Kuçanë dhe grykën e Sylbicës do të shërbejnë për të lidhur rreth 1000 banorët e krahinës së Shipshanit, duke bërë të mundur lëvizjen e mjeteve dhe banorëve për në bjeshkë.

Ura e ndërtuar në fshatin Zall i Madh në Orenjë, ka një gjatësi prej 18 metrash me seksion 2/1 dhe me peshëmbajtje deri në 40 ton. Për ndërtimin e kësaj ure punuan 10 forca dhe 4 mjete.

Kjo urë do të shërbejë për të lidhur fshatrat e Gurakuqit, Floqit, Rinasit, Orenjës dhe Zallit të Madh, duke bërë të mundur që rreth 1300 banorë të lëvizin lirshëm me mjetet e tyre në çdo kohë pa u kushtëzuar nga shirat e moti i keq.

Delegacioni i Organizatës Ndërkombëtare të Ndhimave në Lundrimin Detar (IALA), viziton FD-në

Delegacioni i përbërë nga ekspertët e Organizatës Ndërkombëtare të Ndhimave në Lundrimin Detar (IALA), zhvilloi një vizitë në vendin tonë, e cila pason anëtarësimin e Shqipërisë në këtë organizatë.

Përgjatë vizitës u krye inspektim i zgjeruar për sistemin e sinjalistikës detare, me qëllim dhënien e rekomandimeve për përmbushjen e standardeve të përcaktuara ndërkombëtarisht. Delegacioni i ekspertëve u mirëprit nga komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, shefi i Shtabit i Forcës Detare dhe komandanti i Shërbimit Hidrografik, kapiten i rangut II Artan Malo.

Ekspertët e IALA-s vlerësuan gjendjen aktuale të sinjalistikës detare



dhe dhanë rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e mëtejshëm të këtij sistemi. Akademia e IALA-s, gjithashtu ofroi kurse trajnimi për personelin e Shërbimit Hidrografik Shqiptar, të cilat do të ndihmojnë në arritjen e standardeve të kërkuara ndërkombëtare.

Trupat xheniere të batalionit Xhenios, në shërbim të komunitetit për ndërtimin e urave në bashkitë Tropojë dhe Librazhd





AFA, certifikata mirënjohjeje nga SHSHPFA, Arben Kingji

Në auditoriumin e Ministrisë së Mbrojtjes, me rastin e 65-vjetorit të krijimit të AFA-së, u mbajt ceremonia e certifikimit të personelit të Akademisë së Forcave të Armatosura.

Me motivacionin “Për kontribut të veçantë në shërbim të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për kryerjen me korrektësi dhe përgjegjësi të lartë të detyrave të ngarkuara”, një vlerësim ky i bërë nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji.

Në ceremoni i pranishëm ishte dhe komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Bilbil Bitri, i cili në fjalën e rastit i falënderoi për angazhimin, sakrificën dhe bashkëpunimin me efikasitet, në realizimin e detyrave të këtij institucioni të rëndësishëm të arsimit ushtarak, si një bazë e fortë për brezat e rinj, që duan të jenë në shërbim të atdheut të tyre, në këtë mision fisnik, ku Nderi, Detyra, Atdheu janë trinomi që trupëzon vlerat e ushtarakëve.



Në Zonën e Operacionit të Komandës Rajonale Perëndimore të KFOR-it, u zhvillua stërvitja ‘EAGLE 9’, ku toga Shqiptare e B3k, KFOR -1, pjesë përbërëse e Batalionit Kinetik është angazhuar me detyra të ndryshme si ngritja e Pikës së Vrojtimit për 72 orë dhe patrullim në zonën e Manastirit të Deçanit. Kjo stërvitje kishte si qëllim rritjen e prezencës së KFOR-it në zona të ndryshme të Kosovës dhe rritjen e aftësive bashkëpunuese midis aleateve të NATO-s.



Në Komandën e Forcës Tokësore, nën drejtimin e Regjimentit të Operacioneve Speciale, u mbajt Konferenca Kryesore Planëzuese e stërvitjes “Strong Balkan-23”, që pritet të zhvillohet në muajin nëntor të këtij viti, me pjesëmarrjen e Forcave Speciale të nëntë vendeve të Ballkanit, në kuadër të marrëveshjes së Shefave të Shtabit të këtij rajoni.



360° nga jeta e një dite

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve


Kjo është panorama e një dite, marrë nga një jetë, fundi i së cilës nuk dihet sa pranë mund të jetë?!

Kjo varet nga 'investimi' që ne bëjmë mbi të!

A është zhvillimi i shkencës ai që çdo ditë dhe më shumë po krijon raporte hermetike, vrastare?

Apo ne, 'homosapiensët' e sotëm, po e keqpërdorim pa ditur se ku po shkojmë?!

Reflektim duke parë veten në çdo portret të sintetizuar.



'Femrat, këto luftëtare të lindura'

Gruaja shqiptare ndër vite, është udhëhequr dhe frymëzuar nga emra që kanë bërë historinë. Brez pas brezi, gratë shqiptare që sakrifkuan jetën në emër të shkencës dhe kulturës, mbeten modeli më kuptimplotë dhe i bukur, i të qenit grua dhe nënë. Guximi, fuqia, mençuria dhe vendosmëria e tyre, janë frymëzimi ynë i përditshëm. Një nga frontet më të vështira të angazhimit të grave është përkushtimi i tyre si pjesë e Forcave të Armatosura.

Në historinë e qëndresës shekullore kundër pushtimeve të shumta, gratë shqiptare kanë mbajtur një peshë të rëndësishme. Ato, jo vetëm kanë mbajtur mbi supet e tyre barrën e mbajtjes së familjeve, kur burrat ishin në luftë, por kanë qenë luftëtare të prapavijës dhe vijës së parë të frontit, duke dhënë dhe jetën e tyre për lirinë dhe çështjen kombëtare.

Janë me qindra gra e vajza tribune popullore që kanë qenë dhe komandante, akti i të cilave ka lënë gjurmë në histori dhe ata janë vlerësuar "Heroina të Popullit". Shembulli më domethënës është dhe ai i grave shqiptare gjatë luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare, ku vajzat dhe gratë trimëresha që dalloheshin në betejat, të emëruar komandante e komisare në vijën e frontit, udhëhoqën njësitë, çeta apo reparte, deri në ditën e çlirimit të vendit. Pati dhe prej tyre që dhanë jetën për lirinë, e mbetën burim ndriçues trimërie e atdhetarie për brezat e mëvonshëm.

Miro Tërbaçi, komandantja popullore që vrau pashain e Beratit

Miro Tërbaçi lindi në fillim të shek. XIX, në Tërbaç në rrethin e Vlorës. Miro u rrit mes këngëve dhe u kalit mes vuajtjeve. Mjaft familje të Tërbaçit rezistuan më shumë për të mos paguar taksat. Babai i Miro Tërbaçit dhe vëllai i saj, së bashku me tërbaças të tjerë, zbritën në Vlorë të zemëruar dhe u ankuan para sundimtarit për arrestimet dhe për sekuestrimet e shumta që bënin sejmënët e tij në Tërbaç dhe në mbarë krahinën. Babai i Miros, Bratgjini, u përgjigj përpara sundimtarit se nuk do të paguanin më taksa. Por sanxhaktari i Vlorës kërkonte me këmbëngulje të ushtronte pushtetin e tij të pakufizuar në këtë krahinë kryengritëse. Në këto rrethana, ai vuri më në fund në përdorim armën e tij të zakonshme, vrasjen mbas shpine. Midis shumë trimave që u vranë tradhtisht në fshatrat e lumit të Vlorës ishte edhe i ati e vëllai i Miro Tërbaçit.

Kënga popullore thotë: "E shkreta Miro Tërbaçi,/ Qaj Miro qajë mirë,/ Vëlla e babë derëzinë,/ Moj e rritura bonjake,/ Me lakëra burdullake...".

Miroja u betua se do të merrte hak. Ajo preu flokët si djalë dhe mbasi e hodhi pallën mbi supet, e veshur si burrë, u vu në ndjekje të gjurmëve të vetë sundimtarit.

Në Berat, Miroja u kërkoi trimave të këtij pashai takim me sundimtarin e Vlorës, mbasi do t'i dorëzonte një letër shumë sekrete dhe koha nuk priste. Në kohën që sanxhaktari i Vlorës zbriti nga shkallët e sarajit të pashait të Beratit për të marrë letrën, u qëllua për vdekje nga Miroja dhe ra përdhe i mbytur në gjak nga plumbat e kobures së kësaj trimëreshë.

Pashai i Beratit, i tërbuar nga guximi i rrallë i kësaj trimëreshë, u përpoq me çdo kusht ta shtinte në dorë



atë. Mbarë vendi e priti krahëhapur Miron, e cila me gjithë plagët e marra, u kthye përsëri në krahinën e saj. Kjo është gruaja shqiptare, e paepur.

Rrugëtimi i një historie të lavdishme

Në ditët tona, ndryshe nga shumë vende europiane, të cilat nuk i kanë gratë në role drejtuese (oficere komanduese) në strukturat ushtarake (apo i kanë vendosur vite e dekada pas Shqipërisë), pas Luftës së Dytë Botërore, gratë oficere të Shqipërisë, u përfshinë në strukturat Komanduese në Forcat e Armatosura dhe kryen detyra të rëndësishme. Pas çlirimit të Kosovës, gratë dhe vajzat kosovare që u përfshinë dhe në frontin e luftës, u bënë komandante apo eprore të larta në Forcat e Sigurisë së Kosovës (FSK), të cilat, në fundin e vitit 2018, u bënë pjesë e Ushtrisë së Kosovës, të sapoformuar me vendimin e Parlamentit.

Gratë shqiptare i gjen sot funksionare të larta, si: ministre, gjenerale, deputete, Presidente të Republikës.

Gratë oficere shqiptare, i gjen të punojnë, deri në gradat më madhore (deri Admirale) dhe në shtete të njohura anëtare të NATO-s, deri në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Londër apo vende të tjera europiane.


Nga 50 Admirale që kishte ushtria e SHBA-ve, një prej tyre i përkiste një gruaje shqiptare nga Korça (në fushën e shëndetësisë ushtarake), ndarë nga jeta para pak kohe.

Ndërsa një oficere e re kosovare, pranohet mësimdhënësjë e parë e huaj në Akademinë Mbretërore të Anglisë.

Rëndësia dhe roli i gruas në formacionet ushtarake

Gratë, kanë qenë gjithmonë prezent në ngjarjet e mëdha të historisë tonë, por masiviteti i tyre filloi në Luftën e Dytë Botërore, që përfshiu vendin dhe që vijoi me integrimin e tyre në Forcat e Armatosura pas çlirimit të Shqipërisë.

Pas ndryshimeve të viteve '90, roli dhe rëndësia e gruas në formacionet ushtarake, u ridimensionua si pasojë e zhvillimeve dhe transformimeve që Forcat e Armatosura



përjetuan, në kushtet e demokracisë dhe të integritetit në NATO.

Ato nuk janë vetëm oficere

Vajzat dhe gratë tona janë të përfshira në uniformë ushtarake që në nivelet bazë si ushtarë dhe nënofficere. Ato shërbejnë me një integritet, dinjitet dhe profesionalizëm të admirueshëm dhe për kolegët e tyre djem e burra në uniformë, nga nivelet më të ulëta dhe deri në ato më të larta të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura. Me përkushtimin dhe sakrificat, aftësitë dhe kontributin e tyre, ato kanë ndryshuar përgjithmonë peizazhin ushtarak modern të forcës ushtarake të këtij vendi.

Gratë dhe vajzat në uniformë janë sot vlera, krenaria dhe fisnikëria e Forcave tona të Armatosura, që gëzojnë dhe meritojnë respektin më të madh.

Ato janë përfaqësueset tona nga më të vlerësuarat dhe respektuarat jashtë

vendit dhe në pikat më të nxehta të globit, nga Europa në Azi, nga Amerika në Afrikë. Gratë dhe vajzat në uniformë shërbejnë në Afganistan, në Sudan, në Kosovë e Bosnjë, në Itali e Bruksel. Ato janë pjesë e strukturave dhe misionëve të NATO-s, OKB-së dhe BE-së.

Vajzat ushtarake?

Ato nuk kanë frikë nga kufizimet në grim, rregullat strikte në veshje, modelin e flokëve dhe sjellje. Ato duan të shërbejnë.

Më shpesh, vajzat punojnë si operatore telefonike, radio operatore, inxhinierë, ekonomiste, profesoresha, marrin grada ushtarake më se të merituar.

Ndoshta, profesioni ushtarak do të jetë gjithmonë i rëndësishëm dhe grada ushtarake do të jetë një arsye për krenari.

Gjithnjë e më shumë gra po shfaqen në mesin e burrave të nderuar.



Në historinë botërore, padyshim që një vend të rëndësishëm kanë zënë femrat, që në një mënyrë apo në një tjetër janë bërë protagoniste.

Rusia është një nga ato vende ku femrat kanë një vend të rëndësishëm, me përfaqësimin me rreth 160 mijë ushtarake ose 10% e totalit të forcave. Numrin më të madh e mban Amerika me 170 mijë femra. Franca 19% të ushtarakëve i ka femra. Spanja ka 15 mijë, ndërsa ushtria e Izraelit e ka të detyrueshme për femrat mbi 18 vjeç që janë pa fëmijë, aderimin në uniformën ushtarake.

Por pavarësisht të gjithave, femrat arrijnë ta ruajnë delikatesën, por mbi të gjitha bukurinë e tyre edhe nën uniformën ushtarake.

Gratë ushtarake janë shumë krenare për punën e tyre, ato nuk janë stepur kurrë para asnjë rreziku, duke punuar dhe luftuar në emër të jetë, paqes, të ardhmes së ndritur të fëmijëve të tyre.





BE kundër pandëshkueshmërisë: Përforcimi i luftës me përgjigjet kombëtare, të BE-së dhe globale

Vitet e fundit, është bërë e dukshme se si juridiksioni universal ose ekstraterritorial kanë shërbyer si mjete të fuqishme të mjetit të fundit në luftën kundër mosndëshkimit ndaj krimeve më të rënda: gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës. Janë marrë dënime në lidhje me krimet e kryera, për shembull, në Siri, Afganistan ose Ruandë, për krime që datojnë 40 vjet më parë. Intensifikimi i përpjekjeve për të punuar drejt përfundimit të mosndëshkimit për krimet thelbësore ndërkombëtare është një temë e Ditës së BE-së kundër pandëshkueshmërisë (EUDAI), e cila u mbajt në Lubjanë, Slloveni, më 22 maj.

Në vitin 2016, EUDAI-ja e parë u iniciua me qëllim të ndërgjegjësimit për mosndëshkimin në lidhje me krimet thelbësore ndërkombëtare, të cilat përfshijnë krimin e gjenocidit, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës. Që atëherë, ngjarja është mbajtur çdo maj, dhe organizatorët kryesorë të saj këtë vit ishin Presidenca Suedeze e Këshillit, Komisioni Evropian, Eurojust dhe Rrjeti i Gjenocidit.

Ministri suedez i Drejtësisë z. Gunnar Strömmer deklaroi: “Rëndësia e kësaj ngjarjeje është edhe më e dukshme kur shohim edhe një herë një luftë që po zhvillohet në kontinentin evropian. Suedia dhe Bashkimi Evropian dënojnë në termat më të ashpër të mundshëm luftën e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës. Mbështetja e përpjekjeve drejt garantimit të përgjegjësisë për krimet e kryera në Ukrainë është gjithashtu një nga prioritetet e Presidencës suedeze të BE-së. Por ne nuk duhet të harrojmë luftën kundër pandëshkueshmërisë edhe në pjesë të tjera të botës”.

Komisioneri Evropian për Drejtësi Z. Didier Reynders deklaroi: “Në vitet e kaluara, kam qenë në Ukrainë në shumë raste, ku kam parë nga afër situatën e tmerrshme të konfliktit më të madh të armatosur ndërkombëtar në kontinentin evropian që nga Lufta e Dytë Botërore. Arsyeja pse jemi mbledhur këtu sot është se jemi të vendosur të riafirmojmë se ndjekja penale e krimeve ndërkombëtare mbetet në ballë të luftës globale kundër mosndëshkimit në këto kohë sfiduese”.

Presidenti i Eurojust, z. Ladislav Hamran, tha gjatë ndërhyrjes së tij: “23 maji shënon Ditën e BE-së kundër mosndëshkimit, por kërkimi për drejtësi i kapërcen kufijtë kombëtarë, kontinentalë dhe organizativë. Hetimet thelbësore të krimit ndërkombëtar zhvillohen në një peizazh operacional të fragmentuar dhe kompleks, dhe pikërisht këtu përshatet kontributi i Eurojust-it. Ne bashkojmë ekspertizën, bashkojmë provat dhe sigurojmë bashkëpunim mes prokurorëve dhe gjyqtarëve, në mënyrë që drejtësia të mund të jepet përtej kufijve”.

EUDAI i 8-të u zhvillua në Lubjanë, Slloveni si pjesë e Konferencës Diplomatike të MLA për miratimin e Konventës për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Hetimin dhe Ndjekjen e Gjenocidit, Krimeve Kundër Njerëzimit, Krimeve të Luftës dhe krimeve të tjera ndërkombëtare.



Qëllimi i Konferencës Diplomatike është të zhvillojë negociata zyrtare që do të rezultojnë në miratimin e një traktati të ri shumëpalësh procedural

për ndihmën e ndërsjellë juridike dhe ekstradimin, në mënyrë që të lehtësojë bashkëpunimin më të mirë praktik midis shteteve që hetojnë dhe ndjekin krimet

thelbësore ndërkombëtare.

Draft Konventa parashikon gjithashtu që shtetet palë duhet të vendosin juridiksion ekstraterritorial mbi këto lloj krimesh, kur autori i dyshuar është i pranishëm në territorin e shtetit palë. Më shumë informacion mbi përdorimin e juridiksionit universal në shtetet anëtare është tashmë i disponueshëm në broshurën “Në një vështrim: Juridiksioni universal në shtetet anëtare të BE-së”, i cili u botua nga Rrjeti i Gjenocidit me rastin e EUDAI-t të 8-të.

Veprimtaria filloi me fjalët e z. Didier Reynders, znj. Dominika Švarc Pipan, Ministri i Drejtësisë së Sllovenisë, z. Marko Štucin, Sekretari i Shtetit i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Sllovenisë, dhe një fjalim video nga z. Gunnar Strömmer, Ministri i Drejtësisë i Suedisë.

Pas kësaj, z. Andriy Kostin, Prokurori i Përgjithshëm i Ukrainës, dhe z. Milanko Kajganić, Prokurori i

Përgjithshëm për Bosnje-Hercegovinën, ndanë reflektimet e tyre mbi sfidat e hasura gjatë luftimit të mosndëshkimit gjatë një konflikti të armatosur dhe në dekadat pas përfundimit të një konflikti.

Pjesa e dytë e ngjarjes iu kushtua një paneli diskutimi, duke sjellë përpara mënyrat për të rritur luftën kundër pandëshkueshmërisë në formën e reagimeve kombëtare, të BE-së dhe globale. Grupi i panelistëve përfshinte një sërë praktikuesish ekspertë që përfaqësonin institucionet e BE-së, aktorët kombëtarë dhe rajonalë të llogaridhënies dhe shoqërinë civile. Diskutimi i tyre trajtoi çështje të ndryshme, të tilla si roli mbështetës i Bashkimit Evropian dhe agjencive të tilla si Eurojust në kërkimin e drejtësisë për krimet kryesore ndërkombëtare në një kontekst global, mjetet e bashkëpunimit që kanë qenë më të dobishme në rastet e fundit dhe mjetet e reja në zhvillim, ose zbatimin e masave në nivel kombëtar për të forcuar luftën kundër pandëshkueshmërisë.

Rreziqet nga antibiotikët fluoroquinolone: Masa për të reduktuar rrezikun e efekteve anësore afatgjata, paaftësuese dhe potencialisht të pakthyeshme

Komiteti i sigurisë i EMA-s, PRAC, po u kujton profesionistëve të kujdesit shëndetësor se përdorimi i antibiotikëve fluorokinolone, të dhënë nga goja, injektimi ose inhalimi, është i kufizuar për shkak të rrezikut të efekteve anësore paaftësuese, afatgjata dhe potencialisht të pakthyeshme.

Këto kufizime u futën në vitin 2019 pas një rishikimi në mbarë BE-në të këtyre efekteve anësore shumë të rralla, por serioze. Një studim i financuar nga EMA2 ka treguar se megjithëse përdorimi i antibiotikëve fluorokinolone është reduktuar, këto barna mund të përshkruhen ende jashtë përdorimit të tyre të rekomanduar.

Kufizimet në përdorimin e antibiotikëve fluorokinolone nënkuptojnë se ato nuk duhet të përdoren: për të trajtuar infeksionet që mund të përmirësohen pa trajtim ose që nuk janë të rënda (të tilla si infeksionet e fytit); për trajtimin e infeksioneve jo bakteriale, p.sh., prostatitit jo-bakterial (kronik); për parandalimin e diarresë së udhëtarit ose infeksioneve të përsëritura të traktit urinar të poshtëm (infeksionet e urinës që nuk shtrihen përtej fshikëzës); për të trajtuar infeksione bakteriale të lehta ose të moderuara, përveç nëse ilaçet e tjera antibakteriale të rekomanduara zakonisht për këto infeksione nuk mund të përdoren.

E rëndësishmja, fluorokinolonet duhet të shmangen në pacientët që kanë pasur më parë efekte anësore serioze me një antibiotik fluorokinolone ose kinolone. Ato duhet të përdoren me kujdes të veçantë tek të moshuarit, pacientët me sëmundje të veshkave dhe tek ata që kanë bërë transplant organesh, sepse këta pacientë janë në një rrezik më të lartë të dëmtimit të



tendinit. Meqenëse përdorimi i një kortikosteroidi me një fluorokinolone gjithashtu rrit këtë rrezik, përdorimi i kombinuar i këtyre barnave duhet të shmanget.

Studimi2, i cili vlerësoi të dhënat nga mjedisi i kujdesit parësor në gjashtë vende evropiane (Belgjikë, Francë, Gjermani, Holandë, Spanjë dhe Mbretërinë e Bashkuar) midis 2016 dhe 2021, sugjeron se masat e marra për të kufizuar përdorimin e këtyre barnave si një rezultati i rishikimit në mbarë BE-në pati një ndikim modest.

Një komunikim i drejtpërdrejtë profesional i kujdesit shëndetësor

(DHPC) tani do t'u dërgohet profesionistëve të kujdesit shëndetësor në BE. DHPC do të theksojë se këto produkte duhet të përshkruhen vetëm për indikacionet e tyre të miratuara dhe pas një vlerësimi të kujdesshëm të përfitimeve dhe rreziqeve në pacientë individualë.

Antibiotikët fluorokinolone mund të shkaktojnë efekte anësore serioze që përfshijnë sistemin nervor, tendinat, muskujt dhe nyjet. Mjeku juaj duhet t'i përshkruajë këto barna vetëm sipas përdorimit të tyre të miratuar.

Këto efekte anësore shumë të rralla, por serioze përfshijnë tendinat e përflakura ose të dëmtuara, dhimbje

ose dobësi të muskujve, dhimbje ose ënjtje të kyçeve, vështirësi në ecje, ndjesi gjilpërash, dhimbje djegieje, lodhje, depresion, probleme me kujtesën, gjumin, shikimin dhe dëgjimin, dhe shije dhe erë e ndryshuar.

Gjetjet e një studimi të porositur nga EMA (EUPAS37856) sugjerojnë që fluorokinolonet vazhdojnë të përshkruhen jashtë përdorimit të tyre të rekomanduar.

EMA gjithashtu vë në dukje se studimi ishte subjekt i kufizimeve dhe se për këtë arsye duhet përdorur kujdes kur interpretohen të dhënat e tij.

Ilaçet fluoroquinolone janë një familje e antibiotikëve me spektër të gjerë që vrasin bakteret dhe luftojnë infeksionet. Ato përdoren për të trajtuar disa lloje të infeksioneve serioze kur antibiotikët e tjerë nuk janë të përshtatshëm.

Rishikimi në mbarë BE-në, i kryer në vitin 2018 nga EMA, kishte të bënte me ilaçet fluoroquinolone të dhëna sistematike (nga goja ose me injeksion) dhe ilaçe të thithura dhe ilaçe të mbuluara që përmbajnë ciprofloxacin, lomefloxacin, moxifloxacin, norfloxacin, ofloxacin, dhe prfloxacin. Ilaçet fluoroquinolone janë të autorizuara në shtetë të ndryshme anëtare të BE-së me emra të ndryshëm tregtarë.

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg priti kryeministrin letones, Krisjanis Karins, në selinë e NATO-s, më 24 maj 2023, duke e falënderuar Kryeministrin për kontributet e Letonisë në Aleancë, përfshirë udhëheqjen në shpenzimet e mbrojtjes dhe vendosjen në operacionet dhe misionet detare në Kosovë dhe Irak.

Stoltenberg falënderoi gjithashtu kryeministrin Karins për mbështetjen thelbësore politike dhe ushtarake të Letonisë për Ukrainën, si përmes paketës së ndihmës gjithëpërfshirëse të NATO-s, por dhe duke ofruar trajnime, së bashku me Kanadanë, për mijëra ushtarë ukrainas.

Duke parë përpara Samitit të NATO-s në korrik, Sekretari i Përgjithshëm përshkroi pritshmëritë e tij dhe u shpreh se: “Është jetike që të rritemi dhe të mbajmë mbështetjen tonë për të siguruar që Ukraina të mbizotërojë si një komb i lirë dhe sovran. Në Vilnius ne gjithashtu do të vazhdojmë të forcojmë parandalimin dhe mbrojtjen tonë, me plane të reja rajonale të mbrojtjes, një model të ri force dhe një strukturë komanduese të forcuar. Dhe unë pres që ne do të biem dakord për një premtim ambicioz të ri investimi të mbrojtjes në Vilnius, me 2 për qind të PBB-së tashmë si dysheme, jo si një tavan”.

Sekretari i Përgjithshëm, gjithashtu më herët gjatë ditës, përshkroi në Forumin e Brukselit, përgatitjet për Samitin e Vilniusit që do të mbahet në korrik 2023.

Letonia, një aleat shumë i vlerësuar i NATO-s

Pas takimit që patën në selinë e NATO-s në Bruksel, Sekretari i Përgjithshëm, Jens Stoltenberg dhe Kryeministri i Letonisë, Krisjanis Karins, dolën për shtypin në një konferencë të përbashkët, ku Stoltenberg falënderoi për udhëheqjen dhe përkushtimin personal të kryeministrit letones ndaj NATO-s, ndaj lidhjes transatlantike, si dhe e falënderoi atë për “takimin shumë të mirë dhe produktiv”.

Letonia është një aleat shumë i vlerësuar i NATO-s, tha Sekretari i Përgjithshëm. “Ju kontribuoni në operacionet dhe misionet tona detare në Kosovë dhe Irak. Ju udhëhiqni me shembull. Tashmë shpenzoni më shumë se 2 për qind të PBB-së për mbrojtjen, duke u angazhuar në 2.5 për qind për mbrojtjen nga 2025”, - theksoi Stoltenberg. Ai nënvizoi faktin që Letonia pret “grupin tonë të betejës” të udhëhequr nga Kanadaja, në Adaži, të cilin tha se vizitoi vitin e kaluar me kryeministrin kanadez Trudeau dhe kryeministrin spanjoll Sanchez. “Së bashku me ju, solidariteti i NATO-s, është në veprim”, - tha ai.

“Letonia gjithashtu ofron mbështetje thelbësore politike dhe ushtarake për Ukrainën dhe ne jemi jashtëzakonisht mirënjohës për mbështetjen e fortë që po jepni, përfshirë përmes paketës së ndihmës gjithëpërfshirëse të NATO-s, por dhe duke trajnuar mijëra ushtarë ukrainas në Letoni së bashku me Kanadanë. NATO mund të mbështetet në Letoni dhe Letonia mund të mbështetet në NATO”, - tha Sekretari i Përgjithshëm.

“Ndërkohë avionët aleatë mbajnë qiellin letones të sigurt dhe NATO ka rritur praninë tonë nga Baltiku në Detin e Zi. Por gjithashtu anëtarësimi i Finlandës, dhe së shpejti edhe i Suedisë, është një ndryshim i lojës për sigurinë Baltiko-Nordike.

Sot diskutuam luftën brutale të agresionit të Presidentit Putin kundër Ukrainës. Aleatët e NATO-s kanë ofruar mbështetje të paprecedentë për Ukrainën që nga fillimi i luftës ilegale të Rusisë. Dhe ne do t'i dërgojmë një sinjal të fortë mbështetjeje Ukrainës në Samitin e Vilniusit. Ukraina ka demonstruar aftësinë e saj për të rimarrë territorin. Dhe unë jam i bindur se ata kanë aftësitë që u nevojiten për të rimarrë më shumë territor”, - tha Stoltenberg. Ai tha se i mirëpret njoftimet e rëndësishme të aleatëve për të siguruar raketa lundrimi dhe për të trajnuar pilotët ukrainas për të përdorur avionë luftarakë perëndimorë. “Është jetike që të rritemi dhe të mbajmë mbështetjen tonë, për të siguruar që Ukraina të mbizotërojë si një komb i lirë dhe sovran”, - theksoi ai. “Në Vilnius ne gjithashtu do të vazhdojmë të forcojmë parandalimin dhe mbrojtjen tonë, me planet e reja të mbrojtjes rajonale, që janë një model i ri force dhe që forcojnë strukturën e komandës. Unë pres që do të biem dakord për një premtim ambicioz të ri investimi të mbrojtjes në Vilnius, me 2 për qind të PBB-së si dysheme, jo tavan”.

Angazhim afatgjatë ndaj aftësisë së Ukrainës për të mbrojtur veten

Ndërkohë që disa aleatë të NATO-s kanë rënë dakord të trajnojnë pilotët ukrainas në fluturimin e F-16, por nga ana tjetër aleatët duhet edhe të marrin vendime për të dorëzuar F-16 në Ukrainë. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Stoltenberg, komentoi lidhur me trajnimin e pilotëve ukrainas, ai tha se gjatë muajve të fundit,

“RRUGA PËR NË VILNIUS”

Sekretari i Përgjithshëm falënderon Letoninë për angazhimin ndaj NATO-s



“Kur lufta të përfundojë, ne duhet të gjejmë mënyra për të siguruar që historia të mos përsëritet. Sepse ne të gjithë e dimë se kjo luftë nuk filloi në shkurt të vitit të kaluar, ajo filloi në fakt në vitin 2014 kur Rusia aneksoi ilegalisht Krimenë, dhe, më pas disa muaj më vonë lufta shkoi në Donbasin lindor, dhe më pas pushtimi i plotë vitin e kaluar. Kjo është e gjitha pjesë e një modeli më të gjerë, ku ne shohim se si Rusia ka qenë përgjegjëse për veprimet agresive kundër fqinjëve të tjerë, përfshirë Gjeorgjinë në vitin 2008”, - tha Stoltenberg.

Luftërat janë nga natyra të paparashikueshme dhe askush nuk mund të thotë sot se kur dhe si përfundon kjo luftë. Por ajo që është e rëndësishme

është që kur të përfundojë, të sigurohemi që të ndalet dhe të mos jetë vetëm një pauzë përpara një lufte të re agresive nga Rusia kundër Ukrainës. “Prandaj, ekziston nevoja për të forcuar frenimin dhe mbrojtjen e vetë Ukrainës dhe sigurisht, aftësi të ndryshme, disa prej tyre që kemi diskutuar tashmë, mund të jenë pjesë e atij angazhimi afatgjatë”, - tha Sekretari i Përgjithshëm. “Dhe ajo që NATO bën kur vjen puna për të ndihmuar kalimin nga standardet, doktrinat dhe pajisjet e kohës sovjetike në standardet dhe doktrinat e NATO-s, mund të jetë pjesë e forcimit të aftësisë së Ukrainës për të mbrojtur veten”.

Jens Stoltenberg tha se ai pret që në Samitin e Vilniusit aleatët të bien dakord për një paketë shumëvjeçare për të mundësuar këtë tranzicion dhe ndërveprim të plotë me NATO-n, e cila më pas do të ndihmojë në sigurimin e mbrojtjes që i nevojitet Ukrainës për të parandaluar agresionin e mëtejshëm. Ai solli shembullin e “Kompaktit të Sigurisë së Kievit” që po fokusohet shumë në atë se si të ndërtohet vetë mbrojtja dhe siguria e Ukrainës.

Më pas, përveç asaj që NATO bën për të mbështetur ukrainasit, duke u mundësuar atyre të mbrohen, do të ketë edhe një diskutim për kornizat për Ukrainën. “Mendoj se është pak herët për të përfunduar kornizat e sigurisë për Ukrainën. Është shumë herët për të konkluduar. Por që sigurisht këto çështje do të diskutohen në Samit, por që ai nuk pret ndonjë vendim përfundimtar në mes të një lufte”, - tha Stoltenberg.

Forumi i Brukselit – “Rruga për në Vilnius”

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, gjithashtu më herët gjatë të mërkurës, më 24 maj 2023, përshkroi në Forumin e Brukselit, përgatitjet për Samitin e Vilniusit që do të mbahet në korrik. Forumi i Brukselit është një ngjarje vjetore e organizuar nga Fondi Gjerman Marshall i Shteteve të Bashkuara.

Në një sesion të titulluar “Rruga për në Vilnius”, moderuar nga Helene Cooper e “New York Times”, Sekretari i Përgjithshëm theksoi se aleatët e NATO-s po ofrojnë mbështetje të paprecedentë për Ukrainën dhe janë të vendosur ta mbështesin atë për aq kohë sa duhet. Në Samitin e Vilniusit, udhëheqësit aleatë do të forcojnë më tej marrëdhëniet politike me Ukrainën, si dhe mbështetjen praktike të NATO-s për një afat më të gjatë.

Ai e bëri të qartë se “presidenti rus Putin, ka bërë dy gabime të mëdha strategjike, nënvlerësoi trimërinë, vendosmërinë dhe guximin e Ukrainës, por gjithashtu nënvlerësoi NATO-n. Ai nuk e priste aspak unitetin tonë, vendosmërinë tonë për të mbështetur Ukrainën. Dhe ne kemi dhënë shumë mbështetje për një periudhë të gjatë kohore”, - tha Stoltenberg. Sekretari i Përgjithshëm theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të Evropës dhe Amerikës së Veriut në NATO në një botë më të rrezikshme dhe konkurruese.

Sekretari i Përgjithshëm tha se pranimi i Ukrainës në aleancën perëndimore ushtarake nuk do të ndodhë teksa lufta po vazhdon. Megjithatë, ai tha se Ukraina mund të anëtarësohet në të ardhmen në aleancë. Gjatë ngjarjes të organizuar nga Fondi gjerman Marshall në Bruksel, Stoltenberg tha se “ne të gjithë pajtohemi që Ukraina do të bëhet anëtare e aleancës”. Por, ai shtoi se “nuk është në agjendë anëtarësimi i Ukrainës në mes të një lufte”.

NATO ka bërë vërtet hapa të rëndësishëm në forcimin dhe rritjen e mbështetjes të saj. Sepse gjatë muajve të fundit, tha ai, NATO ka dorëzuar shumë forca të blinduara të rënda, jo më pak tanke moderne luftarake, ‘Leopard’, ‘Abrams’ dhe ‘Challenges’. “Më pas, në javët e fundit ne kemi parë se si Mbretëria e Bashkuar po dërgon raketa të avancuara të lundrimit me rreze të gjatë, të cilat tashmë po bëjnë një ndryshim të rëndësishëm në fushën e betejës. Dhe më pas në ditët e fundit, ne patëm njoftimin se disa aleatë do të fillojnë trajnimin e pilotëve ukrainas”, - tha shefi i NATO-s. Ai tha se ky veprim është kuptimplotë, sepse në një fazë tjetër NATO ka mundësinë që të dorëzojë edhe avionë. “Por se kur do të ndodhë kjo dhe se si, kjo mbetet për t’u vendosur. Gjëja e mençur për të bërë këtë, është ta bëjmë këtë hap pas hapi dhe të fillojmë stërvitjen. Dhe pastaj, varësisht se si evoluon lufta, dhe si evoluon situata në terren, atëherë do të merren vendimet përfundimtare për çështjen e dorëzimit të avionëve”.

Edhe një ditë më parë (23/05/2023), teksa mori pjesë në një takim të ministrave të Mbrojtjes të Bashkimit Evropian në Bruksel, Sekretari i Përgjithshëm tha se aleatët dhe partnerët e NATO-s po ofrojnë mbështetje të paprecedentë për Ukrainën. Ai përshëndeti njoftimin e SHBA-së, Mbretërisë së Bashkuar dhe aleatëve të tjerë evropianë të NATO-s se ata do të fillojnë të trajnojnë pilotët ukrainas në avionët luftarakë të gjeneratës së katërt, përfshirë F-16. Ai theksoi se “kjo është pjesë e angazhimit tonë afatgjatë ndaj aftësisë së Ukrainës për të mbrojtur veten”.

Z. Stoltenberg bëri thirrje për bashkëpunim edhe më të ngushtë midis NATO-s dhe Bashkimit Evropian për të rritur prodhimin e municioneve dhe pajisjeve mbrojtëse, si për të mbështetur Ukrainën dhe për të rimbushur rezervat tona. Ai përshkroi rolin unik të NATO-s në vendosjen e standardeve për të gjithë aleatët e NATO-s, duke ofruar një sinjal të qartë kërkesë përmes objektivave të aftësisë mbrojtëse të NATO-s dhe duke u angazhuar rregullisht me industrinë për të identifikuar pengesat. Sekretari i Përgjithshëm tha se NATO po rishikon objektivat e aftësisë, veçanërisht për municionet vendimtare për betejën, duke i dhënë industrisë sinjalin afatgjatë të kërkesës që duhet të investojë. Ai theksoi gjithashtu nevojën për të siguruar që municionet të jenë të ndërveprueshme dhe të këmbyeshme dhe se nuk ka barriera të reja midis aleatëve evropianë dhe amerikanë të NATO-s.

Sekretari i Përgjithshëm njoftoi se NATO do të zhvillojë një ngjarje jozyrtare me liderët e industrisë transatlantike në margjinat e takimit të ardhshëm të ministrave të mbrojtjes në Bruksel më 15-16 qershor, në të cilin ai ka ftuar gjithashtu Përfaqësuesin e Lartë të BE-së Borrell, komisionerin e BE-së Thierry Breton dhe përfaqësues të Ukrainës. Sekretari i Përgjithshëm theksoi në atë takim gjithashtu rëndësinë e bashkëpunimit NATO-BE për qëndrueshmërinë dhe infrastrukturën kritike, përfshirë përmes grupit të përbashkët të punës.

NATO po shqyrton nënshkrimin e një garancie sigurie për Ukrainën bazuar në modelin e Izraelit, gjë që do të vendoset gjatë Samitit të Vilniusit, tha para pak kohësh Presidenti polak Andrzej Duda. Duke komentuar mbi pyetjen që iu bë lidhur me këtë, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s tha se kjo i takon të ardhmes.

Profesor Agim Kaba, skënderbegasi, Doktor i Shkencave Teknike

Agim Kaba, nxënës i shkollës “Skënderbej”, ndonëse u kualifikua gjatë në fushën ushtarake (dhe për pilot), ishte ndër nxënësit e kësaj shkolle që kanë bërë emër në fusha të tjera.

Inxhinier Agimi, u bë një nga projektuesit e ndërtuesit shqiptar me emër, jo vetëm në Shqipëri por dhe në Moskë, Kinë e SHBA, si ndërtues i veprave tepër të rëndësishme... “Doktor i Shkencave Teknike”, Agim Kaba, ish-skënderbegas i vitit 1953, është një nga specialistët e mirë të fushës, i cili ka projektuar e punuar mbi 30 vite në veprat më të mëdha në Shqipëri si dhe në vepra të ndryshme kapitale në Bashkimin Sovjetik, Itali dhe SHBA.

Agim Kaba ka lindur në Tiranë në vitin 1940. Pas përfundimit të shkollës shtatëvjeçare, nis studimet në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”. Ka mbaruar dhe Universitetin të Tiranës, ku është diplomuar inxhinier topogjeodet në vitin 1962. Ka kryer specializime të ndryshme në Kinë, Itali dhe SHBA. Profesor prej disa vitesh në Universitetin Shtetëror të Tiranës, ka titullin shkencor “Doktor i Shkencave Teknike”.

Ka punuar rreth 30 vjet në Institutin Shtetëror të Projektmeve e pothuaj në të gjitha veprat kryesore të ndërtimit në gjithë territorin e Shqipërisë.

Pas ndryshimeve politike në vend, në vitin 1992, ka punuar me kompaninë italiane “Edilter” të Bolonjës, në Moskë në ndërtimin e Qendrës Ndërkombëtare të Biznesit në Moskë. Në vitet 1997-1999 ka punuar si drejtor kantieri në Stamboll të Turqisë. Nga viti 1999 e derisa doli në pension (viti 2010) ka punuar si inxhinier me licencë amerikane në kompaninë amerikane “Clark Construcion Group” në Washington, Maryland dhe Virxhinia.

Në kujtimet e tij, profesor Agim Kaba do të vinte nëpërmjet një rrëfimi personal për librin “Skënderbegasit ndër vite...”:

Në vitin 1952, kur mbarova klasën e pestë, isha me pushime verore në Peshkopi, tek familja e kushërit tim, që në atë kohë ishte Sekretar i Parë i Partisë për rrethin Peshkopi. Ngaqë isha i vogël e çamarrok, në një familje prej shtatë vetash, ku vetëm babai punonte, më larguan për pak kohë në Peshkopi. Kur po mbushej muaji, në një ditë të nxehtë gushti, më thanë se nesër duhet të kthehesha në Tiranë. Të nesërme më çuan në ca si zyra, ku kishte plot të rinj, të cilët uleshin në një karrige dhe qetheshin komplet. Identifikimin tonë dhe veprimet e tjera i bënte një oficer, kapiten, që ishte dhe gjitoni im në Tiranë e që quhej Qani



Koçollari. Një babaxhan që më mirë e njoha në vitet në vazhdim. Im kushëri më tha: “Do të shkosh në Tiranë në shkollën ‘Skënderbej!’”.

Për këtë nuk ishte pyetur as babai im dhe as unë. Nga njëra anë mu bë qejfi që do të shkoja në shkollën ku ishte skënderbegasi Skënder Çela, që vinte shpesh tek kushërinjtë e tij dhe ne fëmijët iu gëzoheshim uniformës së bukur me dy vija të trasha si gjeneral të pantallonave. Ndërkohë, më vinte keq se po lija familjen dhe shokët e fëmijërisë. Arritëm vonë në shkollën “Skënderbej”, aty ku sot është ‘Spitali Ushtarak’. Për disa vite isha në togën e 4-t, ku ishin më të vegjlit në moshë. Menjëherë na veshën ushtarakë dhe na mësuan se si visheshin pecet. Dhomat e gjumit i kishim në katin e gjashtë. Na porositën që kur të binte boria të ngriheshim me vrap, të vishnim pantallonat e këpucët që i kishim të rreshtuara poshtë me pecet sipër në korridor dhe me vrap të zbrisnim poshtë në gjimnastikën e mëngjesit. Të nesërmen kur ra boria, u ngritëm të gjithë me vrap, ashtu siç ishim të

përgjumur (isha vetëm 12 vjeç), i veshja pecet e këpucët e nxora kokën në dritare, ku ishte një xham i thyer e shikoja poshtë. Pjesa tjetër e xhamit u thyer e unë u llahtarisa, teksa një dorë e më kapi prapa qafës. Një zë i butë doli nga kapter Nokja (Novruzi), që ishte kujdestar në depot sipër e më tha: “Mos u tremb, nuk ka gjë, a u vrave?...Do rregullohet!”. Më pas më tha t’i shkoja pas në depo. Më zgjati një letër ku më tha të firmosja. Ishte një shumë 100 lekë, gjobë për xhamin e thyer. “Do e paguash kur të marrësh rrogën e parë”, - më tha kapter Nokja.

...Në fillim e kisha vështirë të ambientohesha me atë regjim, por shumë shpejt do ambientohesha... Kisha dhe shokët të mi që luanim me orë të tëra futboll... Kujtoj se dhe nëna, vëllezërit dhe motrat e përjetuan me stres të madh mungesën time në shtëpi, por me kalimin kohës u ambientuan. Pas një muaji në shkollë, patëm liridaje. Unë kalova orë shumë të bukura me familjen e shokët e mëhallës. Në këtë shkollë unë kreu klasat 6, 7, 8, 9, 10, pra një vit para maturës. Ishte viti 1957, vit në

të cilin mungoi matura jonë sepse të gjithë shkuam në Shkollën e Bashkuar dhe jashtë shtetit. Ishte 1 korriku i vitit 1957, kur gjithë shkolla ishte rreshtuar dhe pritej të jepej urdhri për hipjen në makina që të niseshim nëpër rrethe për pushimet verore. Unë isha në një grup që ishin grumbulluar për Spartakiadën e Shkollave të Mesme të Tiranës, që për shkak të aktivitetit në proces, do i bënim pushimet më vonë. Komandanti i shkollës tha: “Kush të dëgjojë emrin të dalë përpara!”. Emri i parë isha unë, e më pas 10 të tjerë. Ai na tha se do të shkonim për pilotë në Bashkimin Sovjetik. Një gëzim i paparë u reflektua në fytyrat tona dhe një ‘uuuuaaaa’ shpërtheu nga turma e shkollës që ishte në rresht. Më pas u përqaftua me shokët dhe u nisëm për një destinacion të ri. Pas 10 ditësh, të shoqëruar nga familjet tona, u nisëm për në Bashkimin Sovjetik. Një udhëtim që nuk na kishte shkuar kurrë në mendje më parë... Në aeroportin ndërkombëtar ku ishte aeroplani I-14 vende, hipëm ne dhe 2 apo 3 familje ruse. Mbaj mend, kur mamaja e një

shoku tim, nga më të mirët, Serafin Sheganit nga Lini i Pogradecit i tha mamasë sime: “Të ma ketë pak kujdes djalin se është më i vogël!”. Serafini, vite më pas u bë pilot i shkëlqyer dhe komandant skuadrilje në Rinas. Në vite të tëra e kisha fotografinë time zmadhuar në ato të tjerat, që ishin nga nxënësit më të mirë të shkollës. Vitet kaluan dhe ëndrra ime për t’u bërë pilot u ndërpre në mes pas disa muajve, pasi dola i paafte dhe u ktheva në Shqipëri. Pra, u ndërpre në mes. Mbarova më pas gjimnazin dhe Universitetin Shtetëror dhe u diplomova inxhinier.

...Nga shkolla “Skënderbej” kujtoj me respekt drejtorin e shkollës, Stavri Angjelin, pedagogët e talentuar Gaqo Dilo, Sadete Kasa e shumë të tjerë. Por mbi të gjitha, kujtoj dëshmorë-heronj të kombit, shokët e mi që ishim bashkë në shkollë e në jetë, pilotët e shkëlqyer Azbi Serani me atë korrektesën e buzëqeshjen e tij të ëmbël shoqërore, Sokrat Bashën, lushnjarin që për vite e kisha shok klase e komandant toge, i cili dha jetën në krye të detyrës në një moshë të re...

Durham: Burrat e Kosovës dhe ata të Korçës janë kulmi i racës shqiptare

Në një letër të cilën ia dërgon mikut të saj, gazetarin Henry Nevison, Edith Durham përshkruan momentet e vështira të refugjatëve shqiptarë në Vlorë, të cilët ishin dëbuar nga grekët pas masakrave dhe pasi ua kishin plaçkitur pasuritë. Kjo është koha kur Princi Wied, të cilin Durham e quan Mbret, e viziton Vlorën. Po ashtu, është koha para fillimit të Luftës së Parë Botërore, e cila te shqiptarët ngjallte shpresa për kthimin e Kosovës brenda Shqipërisë natyrale.

*“Hotel Albania”, Vlorë,
27 qershor 1914*

I nderuari z. Nevison,

Në këtë hotel ka qetësi dhe pastërti. Më duhet të them se rroga me të cilën paguhet Malingroot (një oficer holandez) nga Fuqitë e Mëdha (supozoj që këto janë para ndërkombëtare) janë para të hedhura kot pasi që ky, sikur edhe oficerët tjerë holandezë, e çojnë kohën duke ulëritur këngë komike, duke pirë alkool dhe duke ngrënë, kurse pikëpamja e tij politike është tërësisht pro-greke. Ai më tha se e kishin plaçkitur grekët në Korfuz. Në fakt, pos të ndjerit Thomson, i cili u vra, dhe Kroon për të cilin besoj se është oficer i ndershmë, si është më së miri, për të tjerët dyshoj nëse i meritojnë rrogat.

Oficerët holandezë tashti nuk janë në urdhër të askujt; as të mbretit e as të Komisionit për Kontroll. Të gjithë i japin urdhra e kundër-urdhra njëri-tjetrit.

Mbreti (Wied) në mënyrë irrituese më në fund ka treguar ca iniciativa. Të dielën erdhi këtu (Vlorë) me mbretëreshën. Vizita ishte tejet e suksesshme sa që njeriu do të pyeste pse ai nuk e viziton tërë mbretërinë e tij menjëherë.

Turma të mëdha të njerëzve dolën në pritje. Mbretëresha u ndal që t'i shikonte ornamentet e argjendta në gjoksin e një ushtari dhe u rrethua nga turma. Tërheqja ishte e pamundshme. E vetmja mënyrë ishte që ajo të shkonte te karroca dhe ta shkurtonte ceremoninë.

Turma entuziaste i kapi kuajt dhe



qindra njerëz e tërhoqën karrocën deri në qytet, duke brohoritur dhe bërtitur. Disa malësorë, pleq të papastër, me respekt e flladitnin çiftin mbretëror me mindilat e tyre të palarë.

Ata (çifti mbretëror) u dërguan te shtëpia e Syrja Beut, pasi që është shtëpia më e madhe dhe për të cilën gjë mua më erdhi keq. Ata thuhet se janë pro-grekë dhe disa anëtarë të kësaj familjeje kanë shkuar në Korfuz që t'i ikin takimit me mbretin dhe mbretëreshën.

Pasi drekuan, çifti mbretëror organizoi një pritje.

Mbretëresha në haremllek, kurse mbreti me burrat. Unë shkova në ahengun e haremit. Është dëm që kjo pritje u organizua në shtëpi private. Hoteli do të ishte vend shumë më i mirë, pasi që do të ishte vend neutral.

Zonjat e bejlerëve janë aristokrate ekstreme dhe nuk iu pëlqen të shoqërohen me ata të klasës më të ulët. Mbretëresha

kërkoi që unë të shkoja në një bisedë private me të në orën 5:30. Njerëz të shumtë më porositën që ta lajmëroja mbretëreshën që ajo të mos iu besojë këtyre bejlerëve dhe t'i thosha se gratë e tyre vetëm një ditë më parë e kishin vënë në shpotitje, duke thënë se mbreti e kishte shitur tërë pasurinë për të paguar titullin dhe së shpejti do ta shiste edhe mbretëreshën dhe se, Vidët ishin shumë inferiorë ndaj Syrjave.

Unë i tregova (mbretëreshës) që të mos i besonte kësaj familjeje (Syrja beut), pasi që thuhej se ishin pro-grekë dhe se disa kishin shkuar në Korfuz.

Por, ajo u përgjigj duke thënë se nuk iu besonte këtyre fjalëve dhe se mënyra më e mirë për të ushtruar influencë në popull është nëpërmes bejlerëve.

Unë më nuk fola. Ajo më tha se do t'ia jepte 4000 franga Shoqatës së Zonjave dhe më luti mua që të

mbikëqyrja shpenzimin e tyre për fëmijët dhe gratë. Ajo gjithashtu tha se do të jepte edhe dy pako të mëdha me 200 lloje rrobash dhe një sasi të supës pluhur, e cila duhej të zihej dhe shpërndahej.

Shkova te mytesarif (Nexhip Beu), i cili duket njeri shumë i mirë. Ai është nga Peja dhe e ka humbur tërë pasurinë pasi që i ka rënë në duart e malazezëve dhe është aq i përkushtuar për Shqipërinë sa që do ta shpenzonte tërë pasurinë që i ka mbetur. Ai më premtoi një ndërtesë për fëmijët e sëmurë dhe e shkroi menjëherë urdhrin dhe po ashtu e urdhëroi Shoqatën e Zonjave që të shpenzojnë para për shtretër dhe mbuloja. Tashti kam marrë vesh se mbretëresha si dhuratë ia ka dhënë tërë paratë gruas së Syrja beut e jo grave të komitetit.

Tmerri këtu është jashtë asaj që e përshkruajnë fjalët. Pamja më e tmerrshme që kam parë është një grua e ulur mbi disa thasë me fëmijët e saj, tërë familjen, duke vdekur. Ajo ishte e paralizuar deri në masë mizore. Burri i saj është vvarë nga grekët kur e dogjën Kolonjën para disa muajve dhe tërë pasurinë ia kanë plaçkitur dhe djegur. Ajo e ledhatonte djalin e vetëm që ishte vetëm skelet. Këmbët e vajzave ishin aq të holla sa që dridheshin si thupra dhe mezi e gëlltisnin qumështin që ua dhamë ne. Djali vdiq ata natë. Njëra vajzë vdiq të nesërmen. Besoj që edhe tjerët kanë vdekur, por nuk kam patur zemër që të shkoj e t'i shoh. Rast pa shpresë.

Çka mund të bëjë?

Mbi 33 mijë viktima do të vdesin nëse Evropa nuk merr masa. Ata që janë kthyer në shtëpitë e tyre kanë pësuar keq. Grekët e kanë plaçkitur një

familje që e njoh unë. Burri i kësaj familje ka deklaruar se grekët ua kanë prerë grave veshët dhe gishtat për t'ua marrë unazat dhe vathët dhe kjo është dhjetë herë më keq se gjymtimi që kanë bërë malazezët pasi që ata ua prisnin hundët vetëm burrave.

Spencer, një amerikan, më tregoi se në Skorovit ka parë trupa të dy fëmijëve të vegjël dhe një gruaje dhe një burri të krishterë të therur me bajoneta. Grekët i kanë vvarë të krishterët që refuzonin të deklaroheshin grekë.

Në Kuiname, një fshat afër Kolonjës, Spencer ka parë dy trupa të vdekur të dy vajzave pesëvjeçare që ishin dhunuar dhe pastaj ngulfatur. Kjo ishte bërë para syve të nënës së vajzave. Kjo grua dhe këto dy vajzat e saja kanë qenë të krishterë ortodoksë.

Këtu janë ngjallur shpresa të mëdha nga lajmet se lufta në mes Austrisë dhe Serbisë është e paevitueshme. Shqiptarët besojnë se do ta marrin sërish Vilajetin e Kosovës. Dhe deri tashti, sa i përket luftimit të sotëm dhe inteligjencës, burrat e Kosovës së bashku me lojalistët e Korçës janë maja e racës shqiptare. Ata së bashku do t'i 'rregullonin' grekët, sikur Esati (Esat Pashë Toptani) të mos kishte organizuar revoltë në Shijak dhe në Tiranë.

Mbreti e ka vënë Spencerin në komandë të një trupe burrash dhe kjo gjë i ka trazuar holandezët. Raportohet se Fieri ka rënë sërish në duart tona pasi që rebelët janë larguar nga aty. Këto janë lajmet kryesore deri tashti”....



Të bësh më shumë me trajnimin ushtarak të bazuar në simulim

Ushtritë në mbarë botën duhet të vazhdojnë me përparimet e mëdha teknologjike në pajisje dhe të operojnë në mjedise komplekse dhe dinamike, duke përfshirë kërcënimet jo tradicionale dhe rritjen e luftës së informacionit. Ritmi i ndryshimit është aq i shpejtë sa metodat tradicionale të trajnimit nuk janë më në gjendje të pasqyrojnë realitetin e ri operacional.

Në përgjigje të kësaj sfide, teknologjia e sofistikuar e simulimit po zbatohet lehtësisht për të lejuar marinat dhe forcat e tjera të përshtatin ofrimin e trajnimit dhe provave të misionit në mënyrë që të jetë më e rëndësishme për operacionet moderne dhe komplekse.

Disa forca të armatosura gjithashtu duhet të kryejnë operacione të panjohura për to duke përdorur teknologji të re. Si shembull, shumë marina tani po investojnë në një aftësi të re të luftës kundër nëndetësve (ASW), me përvojë të kufizuar paraprake operationale në këtë fushë. Kjo krijon një sfidë të rëndësishme: si t'u mësoni me kosto efektive një sasi të re njohurish, aftësish dhe qëndrimesh për ASW komandantëve, operatorëve dhe mirëmbajtësve të pajisjeve.

Megjithëse buxhetet ushtarake globale zakonisht mbeten të shëndetshme, kur bëhet fjalë për stërvitjen, ushtritë shpesh detyrohen të 'bëjnë më shumë me më pak'. Përballë kësaj sfide, aplikimi i trajnimit të bazuar në simulim paraqet një sërë faktorësh që përbëjnë një rast të konsiderueshëm biznesi në krahasim me metodat tradicionale.

Kufizimet e modelit të klasës

Më parë, kurset e trajnimit mund të jenë kryer brenda një mjedisi klase rreth një pjese të pajisjes fizike. Megjithatë, kohët e fundit, disponueshmëria e këtyre asetëve fizike është zvogëluar dhe kostoja e madhe e dedikimit të pajisjeve vetëm për trajnim do të thotë se kjo mund të mos jetë më një opsion i zbatueshëm.

Në mënyrë të ngjashme, ushtria po kërkon gjithnjë e më shumë të ofrojë trajnime në një kohë dhe vend që mund t'i përshtatet një studenti të caktuar. Ai dëshiron t'i japë përparësi të mësuarit fleksibël, të përqendruar te studenti, i cili mund të ndihmojë në zvogëlimin e zbehjes së aftësive përmes trajnimit rifreskues në kohë dhe gjithashtu të mundësojë ofrimin e trajnimit ndërkohë që personeli i shërbimit është i vendosur në operacione, për shembull në bordin e një anijeje. Sa më shumë që një student të mund të praktikojë dhe të familjarizohet me procedura specifike operationale, aq më pak ka gjasa që ai të vuajë nga zbehja e aftësive.

Prandaj, trajnimi i bazuar në simulim po fiton vull sepse është një metodë me kosto efektive, fleksibël dhe i aksesueshëm që mbështet trajnimin e decentralizuar. Për më tepër, ai mund të sigurojë përmbajtje të saktë të përdoruesit për skenarë urgjence ose gabimesh që do të ishin jopraktike ose të pasigurta për t'u krijuar brenda një klase ose në situata të drejtpërdrejta. Ai gjithashtu mund t'i përshtatet një studenti ose aftësie specifike, duke siguruar fokus më të madh në objektivat specifike të trajnimit ku studenti kërkon më shumë mbështetje.

Kur kombinohen, këta faktorë ofrojnë një rast të fortë biznesi për përdorimin e trajnimeve procedurale të bazuara në simulime - si shembull, përdorimi i sistemit DECKsim të SEA-s, ka ulur koston e trajnimit të Oficerëve të Kuvertës së Fluturimit me më shumë se 50% në krahasim me trajnimin, duke përdorur drejtpërdrejt helikopterë.

Teknologji e aplikuar nga lojërat dhe më gjerë

Teknologjia ka ardhur deri tani vitet e fundit. Zhvilluesit kanë adoptuar teknologjinë e harduerit dhe softuerit tepër të gjallë të lojërave dhe e kanë ripërdorur atë për të ofruar një trajnim intensiv të sigurt, efikas dhe me besnikëri të lartë. Trajnimi i bazuar në simulim synon të jetë fizikisht mjedisor dhe besnik ndaj skenarit dhe funksionalisht i drejtpërdrejtë.

Besnikëria fizike mund të sigurohet nga një kombinim i sinjaleve vizuale, audio dhe lëvizjeje nëpërmjet gjenerimit/grafikës së imazhit 3D, sistemeve të projektimit, kufjeve të



realitetit virtual (VR) dhe sistemeve audio. Bazat e lëvizjes elektrike dhe hidraulike, platformat e dridhjeve dhe pajisjet haptike gjithashtu ndihmojnë në rikrijimin e ndjenjës së lëvizjes, duke aplikuar forca, dridhje ose lëvizje te përdoruesi. Simulimet ofrojnë besnikëri mjedisore, duke marrë parasysh efektet e ndriçimit, efektet e motit dhe topografinë.

Sistemet moderne të gjenerimit të imazheve, shpesh të zhvilluara nëpërmjet industrisë së lojërave kompjuterike, janë të afta të prodhojnë paraqitje vizuale me cilësi të lartë të efekteve të motit, si shiu, bora, era dhe mjegulla. Përveç kësaj, efektet fizike që moti mund të ketë mbi një aktivitet, për shembull zvogëlimi i diapazonit të zbulimit të sensorëve, mund të përsëriten brenda sistemeve moderne të simulimit.

Trajnimi i bazuar në simulim mund të përdorë gjithashtu baza të të dhënave të terrenit me rezolucion të lartë, të cilat përfshijnë lloje të sakta të bimësisë rajonale dhe sezonale për të rritur realizmin. Për aplikimet detare, gjendjet fizikisht realiste të detit dhe paraqitjet nëntokësore mund të miratohen gjithashtu për të siguruar që operacionet e anijeve janë të përshtatshme.

Përshtatja e simulimeve për situata specifike

Sa herë që zhvillohet trajnimi i bazuar në simulime për ushtrinë, duhet të vlerësohen kërkesat fizike, mjedisore dhe funksionale të aplikacionit. Kërkesa e trajnimit do të përcaktojë nëse një pjesë e pajisjes kërkohet të përfaqësohet në mënyrë të saktë hapësinore dhe vizuale ose nëse procedurat kryhen gjatë ditës, natës ose në kushte të ndryshme të motit.

Për më tepër, funksione specifike operationale mund të kërkohet të përfaqësohen me një shkallë të lartë saktësie - të gjithë këta elementë janë të përfshirë në hartimin e sistemit të trajnimit.

Sistemet e simuluar janë veçanërisht efektive për skenarët e trajnimit që kanë një shkallë të lartë vështirësie (d.m.th.,

që përfshijnë një numër të madh hapash ose ndërveprimesh procedurale komplekse), kanë një nivel të lartë rëndësie (për shembull, që përfshijnë pajisjet ose operacionet kritike të misionit ose sigurisë), ose kryhen rrallë që do të thotë se ka një rrezik në rritje të zbehjes së aftësive me kalimin e kohës.

Kur shihet në këtë këndvështrim, nuk është për t'u habitur që shumë forca po aplikojnë teknologji të sofistikuar simulimi për të përmirësuar ofrimin e tyre të trajnimit. Është një zgjidhje efektive stërvitore që redukton besimin në pajisje fizike dhe ofron një qasje më fleksibël me kosto më të ulët. Ai mund të shpërndahet nëpërmjet teknologjive të internetit dhe mundëson mësimin me në qendër nxënësin.

Për më tepër, fleksibiliteti i sistemeve të trajnimit procedural i lejon studentët të bëhen të aftë në një gamë më të gjerë të skenarëve të emergjencës dhe të rrezikshme që do të ishin jopraktike ose të rrezikshme për t'u trajnuar në kushte reale. Ne besojmë se përdorimi i trajnimit simulues do të bëhet gjithnjë e më qendror për trajnimin e personelit ushtarak dhe ndërsa teknologjia vazhdon të evoluojë, hendeuku në besnikëri midis simulimit dhe realitetit do të vazhdojë të mbyllet.

Mjediset e simuluar me besnikëri të lartë dhe softueri i realitetit virtual rrisin kapacitetin për të krijuar trajnime të arritshme dhe më të përballueshme për personelin ushtarak.

Simulimi ushtarak është në gjendje të rikrijojë skenarë që do të ishin kompleksë dhe të kushtueshëm për t'u vendosur në një kontekst fizik të botës reale, por ai ende përballet me sfida në një peizazh të pabarabartë të trajnimit operacional, ku disa vende investojnë më shumë në simulim se të tjerët.

Çfarë është simulimi ushtarak?

Simulimi ushtarak si term i përgjithshëm mund të mbulojë një gamë të gjerë qasjesh dhe aktiviteteve të ndryshme. Simulimet



mund të jenë thjesht analitike, procese të drejtuara nga të dhënat e përdorura në kërkimin dhe zhvillimin (R&D) dhe testimin dhe vlerësimin (T&E).

Anasjelltas, simulatorët e trajnimit ushtarak mund të përfshijnë aspekte të realitetit virtual dhe të shtuar (VR dhe AR) me modele dhe mjedise të krijuara nga kompjuteri për skenarë zhytës, ndërveprues që përgatisin përdoruesit përfundimtarë për gjënë reale.

Lloji i fundit është duke u zhvilluar për të përmbushur të gjitha llojet e kërkesave stërvitore, nga aftësitë luftarake te logjistika dhe disiplina e zjarrit. Duke i konvertuar komponentët thelbësorë të trajnimit në përvoja të simuluar të ndërtuara rreth të trajnuarve, ku mund të reduktohen në masë të madhe kërkesat e kohës dhe kostos të përfshira në trajnimin tradicional të mbrojtjes.

Pse të përdoren simulimet në stërvitjen e mbrojtjes?

Në një farë mase, simulimet janë përdorur prej kohësh nga forcat ushtarake gjatë planifikimit dhe strategjisë. Shumë kohë përpara përdorimit të teknologjisë dhe modeleve kompjuterike, betejat ishin ‘simuluar’ në harta dhe psikologjia e betejës u aplikua për rezultatet dhe manovrat e mundshme.

Lojërat e hershme të tavolinës së luftës gjermane si Königs-Spiel - të ngjashme me shahun, por të luajtura me një sistem lëvizjeje më komplekse pikë për pikë - dhe Kriegsspiel janë padyshim sistemet e para të aksesueshme të disponueshme për forcat ushtarake për planifikimin dhe matjen e rezultateve të mundshme të betejave me skenarë të ndryshëm.

Kriegsspiel i shërbeu veçanërisht kësaj nevojë, duke qenë shumë më i fokusuar te realizmi dhe vendimmarrja e mirë nga ana e lojtarëve.

Duke aplikuar matematikën dhe llogaritjet e probabilitetit në lojëra si Kriegsspiel, ushtritë që ishin ende shekuj larg modeleve të avancuara kompjuterike ishin në gjendje, në një farë mase, të mendonin përpara kundërshtarëve të tyre dhe të planifikonin lëvizje dhe kundërlëvizje të mundshme.

Simulimi modern i luftës

Në shumë mënyra, kjo lidhje e hershme midis lojërave dhe luftimeve do të vazhdonte dhe do të thellohej vetëm pasi teknologjia e avancuar na lejoi të bënim përshkrime më realiste të hapësirës së betejës për argëtim.

Teknologjitë e zhvilluara në dukje për qëllime argëtimi, si VR, e kanë gjetur veten duke u ushqyer përsëri në simulimin ushtarak.

Megjithëse jo të gjithë simulatorët po kërkojnë t’i bëjnë përdoruesit përfundimtarë të gatshëm për luftim, në të vërtetë, njëri synonte të bënte të kundërtën. Vietnami virtual, i zhvilluar në vitet

1990 dhe i vënë në dispozicion në 1997 për përdoruesit e tij të parë, ishte një simulim i krijuar nga një ekip i përbashkët kërkimor nga Georgia Tech dhe Universiteti Emory.

Simulatori ishte një formë terapie ekspozimi për veteranët e Vietnamit që vuanin nga çrregullimi i stresit post-traumatik (PTSD). Angazhimi u tregua i lartë dhe pacienti i parë në veçanti iu përgjigj në mënyrë të brendshme rreziqeve mjedisore brenda botës së simuluar.

Kjo tregon një ‘zmadhim’ të rëndësishëm të aftësive të simulatorëve të luftës që ka vazhduar edhe sot.

Në vend që të simulojnë një mjedis me pamjen e një perëndie, simuluesit tani synojnë të ofrojnë një përvojë të përbashkët që mund të përdoret dhe banohet nga shumë përdorues të njëkohshëm.

Tani, simulimet nuk mund të përdoren vetëm për planifikim dhe strategji të nivelit të lartë, por mund të përfitojnë drejtpërdrejt individët e përfshirë në fusha të ndryshme luftarake dhe të krijojnë skenarë rreth tyre.

Edhe pse ata janë ndërtuar mbi teknologjinë e përdorur kryesisht në argëtim dhe kanë huazuar disa aspekte të ‘gamifikimit’, ato janë

dukshëm të ndara nga diçka e krijuar për argëtim.

Simulatorët e ardhshëm të trajnimit ushtarak

Përdorimi i simulatorëve, veçanërisht atyre të lidhur në rrjet ndërmjet kombeve bashkëpunuese dhe sistemeve të tyre përkatëse, do të kërkojë vigjilencë më të madhe ndaj kërcënimeve kibernetike.

Nuk mund të injorohet mundësia që të dhënat e paçmueshme ushtarake të vidhen nga aktorë të jashtëm. Informacioni në lidhje me taktikat, pajisjet dhe efikasitetin e fushave të caktuara të trajnimit janë pasuri që mund të përfitojnë kundërshtarët nëse vidhen.

Kohët e fundit, Britania e Madhe ka parë se sa thjesht premtimi i përfitimit financiar mund të tërheqë avantazhe për kombet e tjera, dhe nuk është sekret që kombe si Kina dhe Rusia kanë ekipe shumë të sofistikuara të dedikuara për hakerimin dhe mbledhjen e sekreteve nga të tjerët. Por për sa kohë që informacioni i marrë, dhe i përdorur për të informuar, nga simulimi ushtarak është me të vërtetë i mbrojtur, ato i përgjigjen nevojës për trajnime dhe bashkëpunim të hapur, të aksesueshëm brenda koalicionëve që duhet të fitojnë çdo avantazh që munden.



Kongresi i Përmetit, vizioni demokratik dhe vendimet historike të 24 majit 1944

Më 24 maj 1944 filloi punimet në Përmet, Kongresi Antifashist i Lëvizjes Nacionalçlirimtare shqiptare, i njohur si Kongresi i Përmetit.

Kongresi ishte një nga ngjarjet më të rëndësishme dhe vendimtare të luftës antifashiste të popullit shqiptar, një kuvend që riformuloi dhe çimentoi vendimet dhe idetë paraprake që ishin hedhur në Konferencën e Pezës në shtator të vitit 1942.

Duke u mbështetur në hovin dhe iniciativën që kishte fituar tashmë lufta e reparteve partizane në veçanti dhe Lëvizja Antifashiste në Shqipëri, Kongresi i Përmetit saktësoi direktivat për kalimin në stadin final të kësaj lufte, çlirimin e plotë të atdheut. Vizioni i Kongresit shkoi përtej çlirimit të vendit, duke hedhur themelet për mënyrën e qeverisjes dhe duke përcaktuar se kush do të ishte forca që do të merrte në dorë pushtetin në Shqipërinë e lirë, pas shporrjes së pushtuesve gjermanë.

Natyrisht, me vendimet e rëndësishme që ndikuan në jetën dhe fatet e Shqipërisë për dekada të tëra nga ajo ditë, Kongresi i Përmetit ka zënë një vend të rëndësishëm në historinë shqiptare të pasluftës dhe në kujtesën e mbarë popullit shqiptar. Padyshim duhet përmendur se për shkak të kësaj ngjarjeje historike, 24 maji zuri një vend të veçantë në kujtesën e popullit të Përmetit.

KUSHTET POLITIKO-USHTARAKE PËR THIRRJEN E KONGRESIT TË PËRMETIT

Lëvizja Nacionalçlirimtare (LNÇ) dhe Ushtria Nacionalçlirimtare shqiptare (UNÇSH), ose forcat partizane, përballuan me sukses operacionin e dimrit (1943-'44), që ishte një mësymje e koordinuar kundër tyre nga ushtria pushtuese gjermane dhe kolaboracionistët vendas. Propaganda e ushtrisë gjermane dhe ajo e qeverisë kuislinge të Tiranës deklarorin në këtë kohë se rezistenca antifashiste dhe lufta partizane ishin asgjësuar.

Në të vërtetë, me gjithë humbjet që pësoi nga ky operacion, UNÇSH-ja mbijetoi dhe u konsolidua si forcë e rëndësishme luftarake. Në fillimet e pranverës 1944 ajo filloi të zgjerohet me shpejtësi dhe po shtrihej në të gjithë territorin shqiptar. Kështu, nga janari në maj të atij viti, UNÇSH-së iu shtuan brigada të tjera partizane e disa batalione e çeta lokale.

Vrullin e rritjes së lëvizjes partizane në këtë periudhë e përshkruan me përshtypje të veçantë në kujtimet e tij edhe oficeri i misionit aleat britanik në Shqipëri, kapiteni R. Hibbert. Në librin e tij “Fitorja e hidhur”, që është botuar në vitin 1991, ai shkruan: “Zgjerimi i forcave partizane, ose UNÇSH, në pranverë ishte një dukuri e jashtëzakonshme, që i habiti oficerët e misionit britanik, të cilët kishin qenë dëshmitarë të situatës së rrezikshme që kishte kaluar bërthama e forcave partizane vetëm dy-tre muaj më parë”. Me luftën e saj të ashpër kundrejt pushtuesit, organizimin e lartë dhe qëndrimin dashamirës ndaj popullit, UNÇSH-ja fitoi besimin dhe mbështetjen popullore në Shqipëri.

Ajo shihej si e vetmja forcë shqiptare që luftonte për çlirimin e vendit, ringritjen e flamurit shqiptar dhe mbrojtjen e aspiratave e të të drejtave për shumicën e popullsisë shqiptare. Të rinjtë dhe të rejat shqiptarë vërshuan dhe shtuan me shpejtësi rreshtat e formacioneve partizane.

Në fund të pranverës së vitit 1944 iniciativa ushtarake në Shqipëri kaloi në dorën e Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare, gjermanët dhe forcat kolaboracioniste u mbyllën kryesisht në garnizonet e qyteteve, sidomos në Shqipërinë e Jugut. Në planin ndërkombëtar situata gjithashtu ishte optimiste për koalicionin antifashist që udhëhiqej nga tri Fuqitë e Mëdha, Bashkimi Sovjetik, Anglia dhe SHBA-të.

Në përputhje me këtë situatë optimiste, për të bërë bilancin e arritjeve të LNÇ-së dhe për të përcaktuar objektivat dhe platformën për vazhdimin e mëtejshëm të luftës çlirimtare dhe qeverisjen e vendit, Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar vendosi, më 15 prill 1944, thirrjen e Kongresit Antifashist të Përmetit.

PROCEDURA DEMOKRATIKE E ZGJEDHJES SË DELEGATËVE

Është me mjaft interes të përmendet se megjithëse LNÇ operonte në situatë lufte, idetë dhe vendimet për realizimin e zgjedhjeve ishin ide të përparuara e mjaft demokratike.

Në rezolucionin e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar për zgjedhjen e delegatëve theksohej:

“Në kongres të përfaqësohen zonat e lira, zonat e pushtuara nga armiku, brigadat dhe batalionet partizane e vullnetare,



Bashkimi i Rinisë Antifashiste me 10 delegatë dhe Bashkimi i Gruas me 5 delegatë”. Në zonat e çliruara dhe formacionet e ushtrisë delegatët do të zgjidheshin demokratikisht, me votim të hapur, kurse në zonat e paçliruara do të caktoheshin nga këshillat e qarqeve apo të qyteteve.

Haxhi Lleshi, i cili ishte një nga udhëheqësit kryesorë të LNÇ-së, e përshkruan natyrshëm në kujtimet e tij një episod që tregon se si u zgjodhën në mënyrë demokratike, në një miting të hapur, përfaqësuesit e popullit në komunën e Plashnikut (qarku i Beratit), ku ai ishte i dërguar në atë kohë (prill 1944) për të ndjekur zgjedhjet: “Përshtypje të veçantë më ka lënë mbledhja që u organizua në Plashnik, ku morën pjesë rreth 500 vetë e midis tyre afro 100 gra.

U emocionova kur pashë këtë pjesëmarrje të gjerë, mendova sa lart ishte ngritur vetëdija patriotike, antifashiste dhe demokratike e mbarë popullit që po merrte pjesë, jo vetëm për fitoren e luftës kundër pushtuesit e tradhtarëve, por edhe për formimin e pushtetit të ri, tek i cili ai kishte mbështetur shpresat e të nesërmes....

Aty folën edhe aktivistë, burra e gra, të rinj e të reja. Në diskutimet e tyre shprehej përkrahje e plotë për LNÇ dhe thirrjen e Kongresit I Antifashist. Në fund pjesëmarrësit zgjodhën demokratikisht delegatët për në konferencën nacionalçlirimtare të qarkut”. Përfundimisht, megjithëse në kushtet e vështira të luftës me pushtuesit, u zgjodhën 200 delegatët e Kongresit I Antifashist, të cilët përfaqësonin të gjitha shtresat e popullsisë shqiptare dhe mbulonin gjithë territorin shqiptar.

Aty kishte delegatë nga Partia Komuniste Shqiptare (PKSH), përfaqësues nga shtresat nacionaliste, nga ushtria partizane, nga Bashkimi i Rinisë Antifashiste dhe Bashkimi i Grave të Shqipërisë. Forumet drejtuese të LNÇ-së dhe PKSH-së kishin marrë vendimin që Kongresi të mbledhej në qytetin tashmë të çliruar të Përmetit.

VENDIMET E KONGRESIT TË PËRMETIT

Kongresi antifashist i Përmetit, duke pasur parasysh përbërjen gjithëpërfshirëse të delegatëve të tij dhe përfaqësimin e tyre territorial, ishte një kuvend kombëtar apo një asamble kushtetuese që kishte misionin të zgjidhte organet legjislativë dhe ekzekutive, të cilat do të qeverisnin vendin deri në mbarim të luftës dhe më pas, në Shqipërinë e çliruar. Ashtu siç dihet nga dokumentet historike, kongresi zgjodhi së pari Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar (KPNÇ) si organin më të lartë shtetëror; forumin kryesor ligjvënës, përfaqësuesin e vetëm sovran të popullit shqiptar.

KPNÇ zgjodhi Kryesinë e Këshillit të Përgjithshëm që përbëhej nga 25 anëtarë; president i saj u zgjodh Omer Nishani. Së treti, në Kongres u zgjodh dhe Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar, i cili kishte atributet e një qeverie provizore. Ky komitet, apo qeveri provizore, përbëhej nga 11 anëtarë.

Sekretari i përgjithshëm i PKSH-së, Enver Hoxha, u emërua kryetar i qeverisë provizore, kurse nacionalisti i mirënjohur Myslim Peza u emërua nënkryetar i qeverisë provizore. KPNÇ, si organ ligjvënës, qysh në formimin e tij gjatë ditëve të Kongresit, nxori aktet apo vendimet e para të rëndësishme, të cilat patën një

rëndësi të madhe për zhvillimin e mëtejshëm të luftës çlirimtare dhe pavarësinë e Shqipërisë në vitet e mëvonshme.

Vlen të përmenden tri vendimet e mëposhtme, të cilat lanë gjurmë të pashlyeshme në jetën politiko-ekonomike të Shqipërisë dhe përcaktuan drejtimin që do të merrte shteti i ardhshëm shqiptar:

- Të ndërtohet Shqipëria e re demokratike e popullore sipas vullnetit të popullit.

- T’i ndalohet ish-Mbretit Zog kthimi në Shqipëri dhe të mos njihet asnjë qeveri që mund të formohet brenda ose jashtë vendit kundër vullnetit të popullit.

- Të vazhdohet më me ashpërsi lufta kundër pushtuesve gjermanë dhe tradhtarëve shqiptarë, deri në shkatërrimin e tyre të plotë dhe vendosjen e pushtetit demokratik-popullor në të gjithë vendin.

Vendimet e Kongresit të Përmetit treguan se LNÇ dhe PKSH, si forca kryesore lëvizëse e saj, kishin krijuar bindjen se ato do të ishin fituesit e luftës dhe do të qeverisnin vendin pas fitores. Megjithëse ca vëzhgues të huaj e quanin si vetëbesim të teprur optimizmin e drejtuesve të LNÇ-së në atë kohë, ngjarjet e mëvonshme vërtetuan se analiza e situatës që bëri PKSH-ja dhe LNÇ-ja ishte racionale dhe realiste.

Kongresi i Përmetit, duke shpallur person “non grata” ish-Mbretin Zog i vuri atij legalisht damkën e tradhtarit, sepse ai e ktheu Shqipërinë në shtet vasal të Italisë dhe braktisi popullin e vendin (bashkë me shpurën e qeveritarëve të tij) në ditët e vështira të pushtimit fashist.

Gjithashtu, vendimet e këtij Kongresi u dhanë një mesazh të qartë kuislingëve dhe kolaboracionistëve ballisto-zogistë; nuk do të kishte pushtet në tavolinë për ata që bashkëpunonin me armikun dhe as për ata që prisnin të ikte pushtuesi e pastaj “të luftonin”.

Pushteti u takonte atyre që luftonin kundër pushtuesit për çlirimin e Shqipërisë dhe do të mbronin lirinë, të drejtat, interesat dhe aspiratat demokratike të popullit shqiptar. Në zbatim të vendimit të Kongresit për çlirimin e plotë të Shqipërisë, Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së, më 28 maj 1944, nxori urdhrin për fillimin e ofensivës së përgjithshme ushtarake.


Në këtë kuadër, Divizionit I S, i cili sapo ishte formuar, iu komunikua detyra të kalonte Shkumbinin dhe të mësynte forcat gjermane dhe bashkëpunëtorët e tyre vendas në Shqipërinë e Mesme dhe Shqipërinë Veriore. Marshimi i Divizionit I drejt Veriut ishte një moment kyç në luftën për çlirim.

Ai tregoi se tani UNÇSH-ja ishte e aftë për të luftuar pushtuesit në çdo zonë të Shqipërisë, kishte marrë iniciativën luftarake kundrejt armikut dhe së shpejti objektivi i saj do të ishte çlirimi i qyteteve, përfshirë edhe Tiranën. Përfundimisht, edhe sot pas 77 vjetësh, mbështetur në kohën kur u mbajt dhe vendimet e rëndësishme të tij, mund të thuhet se Kongresi i Përmetit zë një pikë kulmore në historinë shqiptare.

Aty u përcaktuan drejtimet për të realizuar qëllimin final të Luftës Antifashiste të popullit shqiptar: çlirimin e plotë të atdheut nga pushtuesit nazifashistë, garantimin e një Shqipërie të lirë e sovranë në mbarim të Luftës së Dytë Botërore dhe vendosjen e pushtetit popullor.

**JERICHO, BREGU PERËNDIMOR**

E vendosur në Bregun Perëndimor pranë lumit Jordan, Jeriko ka qenë i banuar për më shumë se 10 000 vjet. Ky vendbanim përmendet gjithashtu në Bibël dhe ishte i mbyllur brenda mureve prej guri, midis mijëvjeçarit të nëntë dhe të tetë p.e.s., është kështu një nga qytetet më të hershme të fortifikuara në botë. Jeriko është shtëpia e një vendi të njohur si “Mali i tundimit”, ky është një mal në shkretëtirën e Judesë, i identifikuar nga tradita e krishterë si vendi i tundimit të Jezusit gjatë agjërimit të tij 40-ditor në shkretëtirë, një episod i përshkruar në Ungjijtë.

**ATHINË, GREQI**

Kjo listë përfshin padyshim Athinën, zemrën e qytetërimit të lashtë perëndimor, me një trashëgimi unike historike dhe arkeologjike që përfshin mbetjet greke, romake, bizantine dhe osmane. Athina besohet se ka qenë e banuar që nga mijëvjeçari i tretë p.e.s.: në atë kohë, kryeqyteti i sotëm i Greqisë ishte ende një vendbanim i vogël i vendosur në akropolin aktual.

**VARANASI, INDI**

Varanasi është qyteti i shenjtë i hinduizmit dhe qëndron në brigjet e lumit Gange. Sipas legjendës, ai u themelua nga hyjnia hindu Shiva rreth 5 000 vjet më parë. Studiuesit modernë besojnë, megjithatë, se qyteti është ndërtuar rreth 3 000 vjet më parë. Sipas traditës hindu, çdo adhurues duhet të udhëtojë në Varanasi të paktën një herë në jetën e tij dhe të lahet në lumin e shenjtë. Varanasi është gjithashtu i famshëm për tempujt e tij të mrekullueshëm, të gjetur në numër të madh në këtë qytet magjepsës.

**Xi'an, Kinë**

Së bashku me Pekinin, Xi'an është një nga qytetet më të vjetra në Kinë dhe në të gjithë qytetërimin. Ky vendbanim ka më shumë se 3 000 vjet histori, ka parë 13 dinasti të ndjekin njëra-tjetrën dhe ishte pikënisja e Rugës së famshme të Mëndafshit. Është shtëpia e një prej monumenteve më të famshëm në botë: Ushtria Terrakota, e përbërë nga më shumë se 6000 statuja që mbrojnë mauzoleumin e sundimtarit Chi She Huang, perandorit të parë të Kinës dhe promovuesit të Murit të Madh.

Qytetet më të vjetra në botë dhe ku ndodhen ato

Të lashtë, por ende magjepsës janë disa prej qyteteve më të vjetër në planet. Këto vendbanime mund të gjenden në mbarë botën, nga Lindja e Mesme në Afrikë. Lista përfshin vetëm ato qytete që mund t'i vizitoni aktualisht: ja cilat janë ato dhe ku ndodhen disa nga vendbanimet më të vjetra në botë.

**LUXOR, EGJIPT**

Kryeqyteti i faraonëve jep ende zbulime të reja: për shembull, 60 mumie të reja tashmë kanë dalë në dritë këtu në 2023. Luxor qëndron në mbetjet e Tebës antike, e themeluar rreth 4000 vjet më parë dhe është një qendër shumë e rëndësishme arkeologjike: Tempulli e Luksorit dhe Tempulli i Madh i Amunit ndodhen këtu, dhe Lugina historike e Mbretërve është gjithashtu afër.

**PLOVDIV, BULLGARI**

Plovdivi është qyteti i dytë më i madh në Bullgari. Dëshmitë më të hershme të jetës datojnë 8000 vjet më parë, duke e bërë Plovdivin një nga qytetet më të vjetra në Evropë. Gjurmët e qytetërimeve më të rëndësishme në histori mund të gjenden këtu, nga trakët dhe romakët tek bizantinët dhe osmanët. Pasuria e popujve dhe kulturave të ndryshme e ka bërë Plovdivin një qytet unik, ku mund të gjurmohen gjetjet arkeologjike të të gjitha llojeve, kulturave dhe qytetërimeve.

**HANOI, VIETNAM**

Hanoi është kryeqyteti aktual i Vietnamit dhe vendi në të cilin qëndron qendra urbane. Daton të paktën në vitet 3000 p.e.s.. Pavarësisht zhvillimit të madh të popullsisë të shekullit të njëzetë, Hanoi u ofron turistëve shumë relike kulturore të së kaluarës, duke përfshirë kështjellën perandorake të Thăng Long dhe shumë ndërtesa fetare, duke përfshirë tempujt konfucianë dhe faltore budiste.

DJENNÉ, MALI

Djenné është i famshëm për arkitekturën e tij me tulla balte, duke përfshirë Xhaminë e Madhe, e ndërtuar në shekullin e



13-të. E themeluar 2000 vjet më parë, vendbanimi i Djenné ishte një qendër e rëndësishme e tregtisë dhe kulturës, dhe historia e saj është e lidhur me atë të Timbuktu-së, një qendër kryesore e tregtisë së karvanëve nëpër Sahara.

**BIBLO, LIBAN**

Biblo u themelua rreth mijëvjeçarit të tretë p.e.s. dhe është qyteti më i vjetër i qytetërimit fenikas. Biblo kishte marrëdhënie të ngushta tregtare fillimisht me egjiptianët dhe më pas me grekët, të cilët u dyndën në këtë vendbanim në Liban për të blerë papirus. Gjatë shekujve, Biblo ra edhe nën ndikimin asirian dhe persian.

ARGOS, GREQI

Sipas dëshmimeve nga historianët, Argos është vendbanimi më i vjetër në Greqi dhe dikur ishte qyteti më i fuqishëm në rajon. E ndërtuar gjatë epokës së bronzit, ndoshta u rithemelua në vitin 1000 p.e.s. Ndër vendet më të rëndësishme arkeologjike në Argos është teatri, i ndërtuar në vitin 320 p.e.s., i cili në atë kohë ishte ndër më të mëdhenjtë në Greqi dhe mund të mbante rreth 20 000 spektatorë.

**ROMA, ITALI**

Në historiografinë moderne, Roma e lashtë i referohet qytetërimit romak që nga themelimi i qytetit italian të Romës në shekullin e 8-të para Krishtit deri në rënien e Perandorisë Romake Perëndimore në shekullin e 5-të pas Krishtit. Ai përfshin Mbretërinë Romake, Republikën Romake dhe Perandorinë Romake deri në rënien e perandorisë perëndimore. Arkitektura e lashtë romake është shumë e ndryshme nga ndërtesat dhe monumentet e Greqisë së lashtë dhe Egjiptit. Sigurisht, arkitektura romake ishte po aq madhështore në aspektin e shkallës dhe madhësisë, por ishte gjithashtu shumë më praktike në krahasim me modelet e mëparshme arkitekturore.

**REGGIO CALABRIA, ITALI**

Historia e Reggio Calabria ka origjinë mijëvjeçare: historianët e lashtë thonë se e themeluan atë në vitet 2000 para Krishtit. Ishte Ashchenez, stërnipi i Noeut, i cili më vonë i dha emrin e tij gjithë rajonit, Ashkenatia. Kjo trashëgimi e lashtë është ende e pranishme në kujtesën historike të qytetit, në emër të rrugës Ashchenez. Themelimi i qytetit u tregua nga grekët me një atmosferë legjende, duke ia atribuar atë Jokastos, birin të perëndisë Eolus, dhe Herakliut.





“DEFENDER EUROPE 2023”

